



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Dhjetor 2009 • Viti XXVI • Nr. 12 (182) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3SFR, SHBA \$2.50



“Vallë, a nuk është ky Jezusi, biri i Jozefit?” (Gjn 6, 42)

FAQE 8

Shkruan:
ATË BERNARD
CARUANA O.P.



Akademi solemne kushtuar NënësTereze me rastin e 30-vjetorit të laurimit të saj me Çmimin Nobel

FAQE 10-11

Shkruan:
DON ALBERT JAKAJ




Simbolet e Krishtlindjes

FAQE 19

Përgatiti:
DON JETON THAQI

Për shumë mot Krishtlindja dhe Viti i Ri 2010!



Rauf Dhomi, krijues i devotshëm i një bote të magjishme muzikore

FAQE 14

Shkruan:
AKIL KOCI

Intervistë me veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare dhe fetare, z. Marjan Cubi

Në Amerikë mbahet gjallë jeta shpirtërore, kulturore e kombëtare e shqiptarëve

FAQE 12-13



POROSIA PËR KRISHTLINDJE 2009

Meshtarëve, rregulltarëve dhe rregulltareve, besimtarëve katolikë, si dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë,

“Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe” (Is 9,1)

Të dashur vëllezër e motra në Krishtin!

Në prag të festës së Kërhëndellave, lindjes së Zotit tonë Jezu Krishtit, po vij të Ju edhe njëherë, për të shprehë falënderimet e mia për gjithë dashurinë dhe mbështetjen Tuaj gjatë këtij viti. Njëkohësisht dëshiroj, që, së bashku me Ju, të falënderoj Zotin për të gjitha dhuratat që na i ka dhënë, për tërë hirin që e ka derdhur në ne dhe për gjithë dashurinë që ka treguar ndaj të tjerëve nëpërmjet nesh, gjatë këtij viti që po e lëmë pas. Shpresoj shumë që, gjatë kohës së Pritjes (Adventit), me fuqinë e fesë dhe të besimit, kemi arritur të zbulojmë misterin e ngjarjes më të madhe të historisë së qiellit dhe të tokës: Mishërimin e Fjalës, Lindjen e Zotit tonë Jezu Krishtit në Betlehem.

Nga dëshmia e shkrimeve të Shenjta, përvoja e fesë së Popullit të Zgjedhur dhe nga dëshmia e Kishës së Krishtit, zbulojmë se: Ngjarja e Betlehemit ishte momenti më vetëmohues i Hyjit dhe më fatlumi për njeriun. Vetëmohues, sepse Krishti ishte me natyrë Hyj, e barazinë e vet me Të nuk e çmoi si një visar që s'mundet pa të, por ia mohoi vetvetes këtë, e mori natyrën e shërbëtorit dhe u bë i ngjashëm me njerëzit, që ne nëpërmjet përvujtërisë së Tij të fitojmë faljen e mëkatëve, trashëgiminë e shenjtë, bijësinë hyjnore (krh. 1 Kol 3, 12-20).

Krishtlindja, pra, është festa dhe ngjarja kur Zoti hyri në përvojën tonë njerëzore të tokës, dhe nga kjo përvojë na mësoi dhe na ftoi të hyjmë në përvojën hyjnore të Qiellit. Kjo përvojë e vajit të Tij njerëzor në djep, si dhe ajo e këngës sonë hyjnore në Kryq, mundëson shkëlqyeshëm pajtimin e përheshmë mes Zotit dhe njeriut, mes Qiellit e tokës.

Prandaj, jemi përgatitur me gëzim për të festuar Natën e Krishtlindjes, festën e një fillimi të ri dhe një jetë të re me Zotin.

Me ardhjen e Tij në botë, Jezu Krishti na e zbuloi dashurinë e Hyjit për ne dhe në mënyrë të përfjetshme e “mishëroi” atë në zemrat e atyre që i besuan dhe nëpërmjet tyre vazhdon të rrezatojë dashuria e Tij mbi tokë dhe t'i ndriçojë zemrat e të gjithë njerëzve vullnetmirë.

Pra, Krishtlindja është misteri, i cili na zbulon fytyrën e vërtetë të Hyjit, dhe njëkohësisht është edhe misteri që zbulon fytyrën e vërtetë të njeriut, sepse ia rikthen atij dinjitetin e humbur.

Kisha e përgjithshme e shpërndarë në katër anët e botës, duke dëshmuar ngjarjen e Betlehemit dhe duke dhuruar dashurinë, që Zoti i dha asaj në Jezu Krishtin, është sot “Shpella e Betlehemit” dhe vendshenjtërimi i të gjithë atyre që besojnë dhe ushtrojnë dashurinë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit.

Dimensioni tjetër i Festës së Krishtlindjes shfaqet gjatë ushtrimit të dashurisë dhe shenjtërimin për të mbajtur gjallë shpresën, se: Ai do të vijë përsëri për të gjykuar të gjallët dhe të vdekurit! E, kur do të vijë, dëshirojmë të na gjejë duke iu lutur Atij e duke e lavdëruar Atë.

Krishtlindja na mëson se gëzimin duhet ta kërkojmë atje ku nuk presim ta gjejmë. Jo në një pallat, por në një shpellë; jo në një njeri të pushtetshëm, por në një Foshnjë të brishtë, jo në gjëra materiale, por në hirin që na u shfaq nëpër Jezu Krishtin i cili na mundëson që të jetojmë një jetë plot me urtësi, drejtësi dhe dashuri me Hyjin” (krh. Tit 2, 12).

“Mos ki frikë!” – “Mos kini frikë!” Këto fjalë i dëgjojmë shpesh në liturgjinë e Krishtlindjes. I dëgjojmë nga goja e Isaisë për një popull të dëshpëruar, nga goja e Engjëllit Lajmëtar për Marinë, që të pranonte

të bëhej Nëna e Zotit, e më vonë edhe nga kori i engjëjve për barinjët në Betlehem, që t'i japin lavdi Hyjit në më të lartin qiell. Këtë mision e ka Kisha që ta ftojë njeriun e shekullit XXI të mos ketë frikë, sepse si e kaluara, si e sotmja dhe e ardhmja, i takojnë vetëm Zotit, e ne mund të jemi trashëgimtarë të kohërave, vetëm nëpërmjet Tij.

Fort të dashur vëllezër dhe motra,

me të njëjtën fe dhe dashuri dëshiroj t'ju ftoj të gjithë juve që bashkë me ne kremtoni ose na uroni që të kremtojmë sa më mirë, të mos keni frikë nga askush dhe nga asgjë, sepse nëpër Krishtin jemi bërë trashëgimtarë të Pronarit të Qiellit dhe të tokës, prandaj, gjithëçka e tij na takon edhe neve. Ju të varfër mos keni frikë të vuani varfërinë tuaj, ashtu siç Krishti s'kishte frikë të vuante mundimin e Kryqit. Ju të rinj mos keni frikë nga e kaluara, sepse ajo mund të përmirësohet sot dhe mos keni frikë nga e ardhmja, sepse ajo ju takon juve. Ju mund ta humbni atë, ose t'ia dhuronin plot fryte gjeneratave të ardhshme. Mos ke frikë t'i që të urrejnë, sepse është dashuria e Zotit që të gjithëve na krijon mundësinë të duam pa kufi dhe të jemi të gatshëm të falim çdoherë, pa shpërbim e pa kusht.

Të dashur, nga përvoja shumëshekullore e fesë, ne të krishterët kemi dëshmuar se gjatë miqësisë me Krishtin, kemi mësuar t'i mbetemi besnikë fesë dhe të mos lejojmë që asnjë pasuri tokësore, asnjë fuqi dhe asnjë pushtet të mos na ndajë nga dashuria e Tij dhe që dashuria e jonë për të afërmin duhet të rrezatohet njëkohësisht për të gjithë njerëzit pa dallim, si për të vegjël, ashtu edhe për të mëdhenj, si për të varfër, ashtu edhe për të pasur, si për njerëz të ditur, ashtu edhe për të paditurit, si për të mirë, ashtu edhe për të keqinjtë. Nëse ndonjëherë vërehet çfarëdolloj ndasie, ajo kurrë nuk guxon të burojë nga mungesa e dashurisë së të krishterëve. Ne duhet dhe duam t'i duam të gjithë, pa dallim, edhe pse ata që i duam shpeshherë ndahen në ata që na përgjigjen me dashuri dhe në ata që na përgjigjen me urrejtje.

Vëllezër dhe motra, të dashur miq dhe ju njerëz vullnetmirë, në fund dëshiroj të Ju siguroj lutjet e mia të përzemërta dhe plot dashuri për ju, që të jeni të gatshëm për të pranuar haret dhe bekimet që Zoti i ka bërë gati për ne dhe nëpërmjet nesh ia dhuron botës.

Edhe njëherë Për shumë mot Krishtindja dhe urime për vitin e Ri 2010.

Ispeshkvi Juaj, **Dodë Gjergji**
Prizren, 24 dhjetor 2009

Veprimtari në përkujtim të Adolph Kolpingut

Prizren, 5 dhjetor 2009

Në qytetin e Prizrenit u mbajt takimi i organizatës *Kolping Kosova*. Arsyeja pse u zhvillua ky takim, ishte një moment i gëzuar dhe i shumëpritur për shumë kohë, pasi që prej vitit 2000, kur *Kolpingu* ka nisur veprimin e vet edhe në Kosovë, duke ndihmuar në shumë fusha të jetës, tashmë ka edhe pronën e vet. *Kolping Kosova* ka edhe përfaqësinë këtu, nga e cila tashmë do ta shtrijë aktivitetin e vet, pasi që hapësira është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për punë efektive, ndërsa shtëpitë private, në të cilat ka vepruar organizata Kolping Kosova duket se do t'i përkasim të së kaluarës.

Ndërtimi i shtëpisë së *Kolping Kosovës* filloi në vitin 2007 në Prizren dhe për periudhën dyvjeçare projekti është në përfundim e sipër. Në organizatën Kolping Kosova janë të anëtarësuar 16 famullitë të Kosovës, dhe në vitin 2010 kjo organizatë mëton të numërojë në gjirin e saj edhe 5 famullitë të tjera.

Një aktivitet tjetër pranë kësaj qendre, është edhe qendra për aftësimin e të rriturve (QARR), qendër kjo e cila kohëve të fundit ka ngjallur interesim shumë të madh nga të rinjtë, ku ndër të tjera zhvillohen lëndë të biznesit modern.

Duke konsistuar në të njëjtën ditë me natën e shën Kollit, festë e rëndësishme në jetën dhe shoqërinë katolike shqiptare e mbarëbotërore, pastaj edhe ky moment gëzimi ishte një motiv më tepër t'a ndiejmë këtë moment të shumëpritur.

Në fillim u mbajt mesha në



Gjatë kremtimit të Meshës në Prizren

orën 11, në katedralen e Prizrenit, të cilën e drejtoi imzot Dodë Gjergji, në praninë e mbarë kryesisë së Kolping Kosovës dhe mbarë anëtarëve të kësaj organizate nga 16 famullitë e Kosovës ai ndër të tjera u shpreh: *Ndihem i lumtur dhe shumë i gëzuar pasi sot na bashkojnë dy ngjarje të rëndësishme, dita e përkujtimit të Adolph Kolpingut, si dhe ndërtimi i shtëpisë së Kolping Kosovës, me të cilën duhet të mburrimi.* Ai ai foli për jetën e Kolpingut dhe vështirësitë me të cilat u ballafaqua gjatë jetës, ai përmendi edhe rastin famëmadh të Adolph Kolpingut, i cili kishte kërkuar nga punëtorët e varfër të asaj kohe që ato paga që merrnin nga puna e tyre, dhe që nuk mjaftonin për jetën e tyre, të kursenin pak nga to në mënyrë të vazhdueshme duke qenë më vonë një ndihmesë e madhe për jetën e tyre, ide nga e cila linden më vonë edhe sigurimet

e para shëndetësore, jo vetëm në Gjermani, por edhe më tej.

Imzot Dodë Gjergji bëri ftesë të mbarë njerëzit për bashkim e unitet shpirtëror dhe në vepër. Këtë e kërkoj se pari nga anëtarët e Kolping Kosovës dhe bëri thirrje që të mos ndahen për asnjë moment nga jeta vepra dhe mësimet e Kolpingut, dhe se vetëm me këtë mënyrë jemi në vazhdimësinë e mësimëve dhe hapave të tij.

E shohim të udhës që për hir të lexuesit të japim një biografi të shkurtër të Kolpingut.

Adolph Kolping u lind më 8 dhjetor 1813 në Kerpen të Gjermanisë dhe vdiq në moshën 51-vjeçare më 4 dhjetor 1865 në Këln (Cologne). Në moshën 18-vjeçare ai ishte ndihmës i një këpucëtar në Këln. U interesua për kushtet jetësore të njerëzve, të cilët jetonin aty, nga ku mori vendimin që të bëhej prift katolik, pra në shërbim të të tjerëve dhe

në përpjekje të një jete më të mirë të njerëzve të varfër.

Më 6 maj 1849 ai themeloi në Këln shoqatën e çirakëve të Këlnit që u bë edhe pika e nisjes së vepërës së Kolpingut. Papa Gjon Pali II e ka shpallur të lumtur më 27 tetor 1991.

Më pas Ipeshkëvi i Ipeshkvisë së Kosovës imzot Dodë Gjergji vizitoi shtëpinë e Kolping Kosovës ku u prit nga kryetari i Kolping Kosovës Nikollë Kërhanaj. Ati shpirtëror don Kelmend Spaqi si dhe Drejtori Arben Thaqi.

Imzot Dodë Gjergji pasi bekoji shtëpinë e re, ai në një fjalë rasti përshëndeti punën dhe përkushtimin e treguar ndaj punës dhe shprehur dëshirën e madhe për të qenë mbështetje dhe një shtysë e madhe në realizimin e shumë detyrave, ai tha se Adolph Kolpingu ishte këpucëtar, por e la zanatin e vet që të na mësojë hapat e jetës, dhe pasi tashmë kemi vendin nga ku do të orientohejmë, qëndroni dhe t'i ndjekim së bashku ata hapa të jetës që janë rezultat e frytit të punës së Kolpingut.

Dhe në praninë e ipshkvit kryetari i Kolping Kosovës Nikollë Kërhanaj prezantoi realizimet vjetore të kryera nga anëtarët e Kolpingut që ishin; vizita e rinisë Kolping në Berlin, seminari në Bogaj, takimi i rinisë në Kuçisht të Rugovës, pastaj seminari në Shkodër, takimi në Tiranë me përfaqësuesit e projektit BMZ me Gregor Federhen. Pas këtij prezantimi u shtrua edhe një koktej rasti.

(Jozef Krasnig)



Mons. Dodë Gjergji, Don Kelmend Spaqi dhe z. Arben Thaqi

Ripërtëritje shpirtërore në Kohën e Ardhjes

Me Të Dielën e parë të Ardhjes kemi filluar periudhën e një përgatitjeje të fortë shpirtërore për kremtimin e festës universale të gëzimit, Krishtlindja. Pasi që Krishtlindja i flet zemrës, edhe zemrës së njerëzve që nuk besojnë, por që nuk mund të mos ndjejnë, në këtë periudhë 'diçka të jashtëzakonshme e të mbinatyrshme', sepse ardhja e një fëmije, që na pushton ndër krahë, nuk mund të mos jetë ngjarje tejet gazmore.

Të gjithë flasin sa ditë ende kanë mbetur për blerje para Krishtlindjeve. A do t'i dërgoj letër-urimet me kohë? Kjo kohë brenda vitit është me shtrëngesa të mëdha për shumë persona. Kohë e stresit! Shumë detyrime, por pak kohë! Si shërbëtorë të Jezusit kemi fituar dhuratën e kohës që quhet Ardhja (Adventi). Kjo është një rast që shkurt t'i shmanget shpejtimin të egër. Ky është një rast i mirë që pak të tërhiqemi dhe ta presim Hyjin që vjen. Hyji ka ardhë para dy mijë viteve, mirëpo vazhdon në mënyrë permanente të vijë në



Meshtarët dhe murgeshat në dëgjim të ligëritas të mbajtur nga Mons. Dodë Gjergji

jetën tonë dhe në zemrën tonë këtyre ditëve në muajt nëntor dhe dhjetor. Dëshirojmë të jemi të gatshëm për këtë ardhje. Për këtë arsye edhe ne meshtarët e murgeshat bëjmë këtë ripërtëritje shpirtërore.

Pikërisht ripërtëritja shpirtërore është si pushim i vogël vjetor që e kalojmë me Zotin. Gjatë kësaj kohe të shkurtër dëshirojmë ta kalojmë kohën me të, duke e dëgjuar çka na flet Hyji në jetën tonë, në këtë kohë të Ardhjes. Kur tërhiqemi në heshtje, presim se çfarë dëshiron të ndajë Hyji me ne (ty). Dhe pikërisht ftesa që na drejtoi Imzot Doda si udhëheqës i kësaj ripërtitje

shpirtërore, në Rezidencën e re Ipeshkvnore në Prishtinë, që u mbledhen gjithë meshtarët e murgeshat në këtë periudhë të Ardhjes, që njëkohësisht ishte rast i mirë për një ripërtëritje të vërtetë të jetës në Zotin.

Megjithatë gjatë ripërtitjes shpirtërore qdo njeri prej nesh është përpjekur të tërhiqet në vende të vetmuara. Ka provuar "të ikë" nga përditshmëria. Kësaj rradhe kemi shkuar në një vend tjetër duke gjetur një hapësirë të përshtatshme për meditim, qetësi e lutje.

(Don Robert Jakaj)

Seminari i Prizrenit në ushtrime shpirtërore në Shkodër

Në bashkësinë tonë të Seminarit përveç mësimin, lutjes, argëtimit dhe aktiviteteve të shumta dhe të ndryshme praktikohet që në ndër kohë të tërhiqemi për një kohë të shkurtër nga obligimet dhe punët e përditshme dhe futemi në përvojën shpirtërore, ku përmes lutjes, leximit të Shkrimit Shenjt, meditimit dhe adhurimit mundohemi të kuptojmë më mirë atë çka Zoti kërkon dhe dëshiron nga ne. Më 27 nëntor, në prag të fillimit të Kohës së Ardhjes, ne seminaristët e Seminarit të Prizrenit në krye me don Antonin, rektorin e Seminarit, udhëtuan për në qytetin e lashtë të Shkodrës për një periudhë katër ditore në përvojë të Ushtrimeve Shpirtërore.

Përvoja e ushtrimeve shpirtërore, për të gjithë ne ishte diçka e jashtëzakonshme dhe shumë frytdhënëse. Gjatë atyre ditëve, duke e falënderuar don Aleksander Mayer i cili na mbajti ushtrimet shpirtërore me një thjeshtësi dhe urti vërtetë ungjillore, kuptuam edhe më shumë dashurinë që Zoti ka për secilin për ne dhe lirisht mund të themi se gjatë asaj përvojë ushtruar që edhe ne ti përgjigjemi bujarisë, mirësisë, mëshirës dhe dashurisë së Zotit me besim dhe dashuri.

'Zoti na do pa masë' ishte tema, ku përmes figurave dhe ngjarjeve të ndryshme biblike na u komunikua dhe na u dëshmu



Seminaristët me drejtuesin e ushtrimeve shpirtërore, don Aleksander Mayer

se vërtetë Zoti na do pa masë.

Gjatë qëndrimit tonë në Shqipëri patëm mundësi edhe të vizitojmë disa nga Kishat dhe manastiret, kështu që na u dha mundësia të kuptojmë më për së afërmi vuajtjen dhe martirizimin e kësaj pjese të popullit tonë. Duke dëgjuar - në njërin anë - për vuajtjet, rrahjet, padrejtësitë dhe vrasjet e shumta dhe të padrejta që iu shkaktuan Kishës në Shqipëri dhe - në anën tjetër - për qëndresën dhe dashurinë për fenë dhe të vërtetën, ideale këto për të cilat shumë pranuan edhe martirizimin, në zemrën dhe mendjen tonë u zgjua një dëshirë edhe më e madhe për të ju kushtuar Krishtit dhe popullit në shembullin e pashoq të martirëve tanë.

Ditët që kaluam në Shkodër po ashtu ishin një mundësi për të njohur më për së afërmi Seminarin e madh të Shkodrës, ku pas përfundimit të Seminarit të Ultë këtu në Prizren, do t'i vazhdojmë studimet e mëtejshme filozofike dhe teologjike.

Falënderojmë Zotin për të gjitha huret dhe bekimet që i zbrazi mbi ne gjatë atyre ditëve, falënderojmë edhe rektorin tonë don Anton Ukaj, i cili na propozoi dhe na mundësoi këtë përvojë të mrekullueshme, gjithashtu falënderojmë edhe don Aleksander Mayer si dhe rektorin e Seminarit të Shkodrës për pritjen e mirë dhe ngrohtësinë që tregoi ndaj nesh.

(Seminaristët - Prizren)

Koncert i Korit të Filharmonisë së Kosovës në Katedralen e Prizrenit



Prizren, 12 dhjetor 2009

Drejtori i Korit të Filharmonisë së Kosovës z. Baki Jashari së bashku me meshtarët e Katedrales, në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si edhe me Televizionin "Opinion", organizuan Koncertin Premial me rastin e 30 vjetorit të "Çmimit Nobel për Paqë" i cili iu pat dorëzuar Nënë Terezës në Oslo.

Kori i Filharmonisë së Kosovës, i përbërë prej 50 antarëve, vazhdon punën e Korit profesional të ish Radio-televizionit të Prishtinës nën drejtimin e dirigjentit të njohur Kosovar z. Rafet Rudi-t.

Programi filloi në Katedralë me Koralin: "Calvary" të Georges Aubanel, pastaj me "Pater Noster" të Giuseppe Verdi-t, me "Trois Beaux oiseaux du Paradis" të Maurice Ravel me sopranen Adelina Thaqi, alt Diellza Syljmani, tenor Ergin Brahimi dhe

bas Denik Prizreni; vazhdoi me "Nunc dimitis" të Arvo Pärt; "Voda Zvira" të Josip Sh. Slaven-ski, "Në pyje vjeshta ndezi zjarre" me sopranen Besa Llugiqi, mexosopranen Sanije Matoshi, tenorin Riad Ymeri. Pastaj, "Ç'u mbush mali" të Vasil Tole, "Ti me sytë e zi" të Vinçenc Gjini, "Salve Regina" të Kushtim Gashi dhe me violinë u paraqit Visar Kuçi me "Udhëtim sonnor për violinë, piano dhe kor" i përcjellur në piano nga Misbach Kaçamaku.

Në përfundim, famullia e Prizrenit bëri një koktej falënderimi për anëtarët e Filharmonisë ku atmosfera e përzemërt u dha shprehje të dy palëve se bashkëpunimi në mes Korit të Filharmonisë dhe Katedralës së Prizrenit do të jetë i vazhdueshëm.

Televizioni Opinion bëri regjistrimin profesional të koncertit, i cili, të dielën me 13 dhjetor u transmetua në tërësi.

(Dritapress)

Festa e shën Kollit në Kabash

Përgatitjen shpirtërore për festën e pajtorit tonë shën Kollit e kemi filluar 9 ditë para festës me meshën shenjte. Kisha ishte përplot me besimtarë të ardhur edhe nga famullitë tjera, ndërsa meshën çdo ditë e printe nga një meshtarë të cilin e kishte ftuar famullitari ynë. Gjatë rruzares meshtarët rrëfenin besimtarët e shumtë. Meshtarët me predikimet e tyre të bukura i nxitnin besimtarët tanë në rrëfim e në uratë. Natën e festës meshën e udhëhoqi ish famullitari ynë don Lush Gjergji, në bashkëmshim me famullitarin tonë don Albertin dhe meshtarin e KFOR - it amerikan. Kisha ishte përplot besimtarë dhe fëmijë, si dhe ushtarë të KFOR - it. Pas meshës erdhi shën Kolli, i shumë pritur nga fëmijët, me engjëjt e vet dhe engjëlli i keq që i tundonte fëmijët për mos ta dëgjuar shën Kollin. Pra, pas një drame të vogël, të përgatitur nga m. Monika e m. Tena, shën Kolli fëmijëve iu ndau mbi 300 dhurata.



udhëhoqi ipeshkvi ynë Mons Dodë Gjergji, në bashkëmshim me shumë meshtarë të tjerë, e që gjatë predikimit theksoi rolin e madhe të shën Kollit në jetën e besimtarëve, të cilët më shumë se çdo shenjt tjetër e lusin edhe laramanët tanë. Ipeshkvi ynë i ftoi besimtarët të marrin shembullin e shën Kollit e të jenë të gatshëm në flajim për vlerat fetare dhe kombëtare si dhe bujarë ndaj vëllait njeri. Vlen të theksohet këndimi shumë i bukur i korit të famullisë.

Festa e shën Kollit ishte një ripërtitje e vërtetë shpirtërore e famullisë sonë.

Shën Kolli - lutu për ne!

(Klodina Gashi)

Ditën e festës meshën e

Inaugurimi i qendrës së re e Misionit tonë në Luzern

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern, është Misioni i parë që u hap në Zvicër nga Don Aleksandër Kola. Pas punëve të shumta të meshtarëve të tjerë, më në fund u realizua dëshira e kamotshme për të pasur një qendër të re, e para e këtij lloji, që i plotëson nevojat pastorale të Misionit. Fal Zotit, njerëzve vullnet mirë dhe angazhimit tonë kjo tani u bë realitet.

Nuk është e lehtë të përshkruhet mbrëmja e mrekullueshme e së shtunës të datës 28 nëntor. Vërtet ishin momente gëzimi që shënonin kulmin e një pune shtatëmbëdhjetëvjeçare të Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, përfshirë këtu sidomos dekadën e fundit të punës së madhe të angazhimit maksimal fetar dhe kombëtar të misionarit Don Marjan Demaj. Atë mbrëmje nëntori, pikërisht në Ditën e Madhe të Flamurit Kombëtar, kishin ardhur në Luzern personalitetet të shumta kishtarë, bashkatdhetarë e intelektualë të fushave të ndryshme për ta shënuar në mënyrë sa më dinjitoze inaugurimin e Qendrës së re të Misionit Katolik Shqiptar të Zvicrës Qendrore, e cila siç u tha është e para qendër e pranuar zyrtarisht nën ombrellën e përshkëmt me kishën zvicerane.

Në hapje të manifestimit përurues, kori i Misionit, i udhëhequr nga motrat Violeta dhe Mrika, bashkë me të pranishmit kënduan këngën Laudate Omnes Gentes në gjuhën shqipe, latine dhe gjermane.

Në mesin e shumë bashkatdhetarëve ishin të pranishëm edhe ipeshkvi i Kosovës, Dodë Gjergji, arqipeshkvi i Tivarit Mons Zef Gashi, ipeshkvi i Sapës (Shqipëri) Mons Lucjan Augustini, ambasadori i Shqipërisë z. Mehmet Elezi, disa meshtarë nga Kosova dhe misionarët tanë në Zvicër si dhe motrat nga Thurgau. Ishin të pranishëm edhe shumë personalitete e përfaqësues të kishës zvicerane, të cilët kanë dhënë kontribut të madh si z. Marco Schmid drejtor për të huajt, Daniel Vasalli sekretar në entin e përkujdesjes për të huajt, Daniel Untermährer, asistent pastoral në kishën e shën Mihillit, kryetari i Partisë Demokratike për kantonin e Luzernit z. Martin Schwegler etj.

Në fjalën e rastit, në gjuhën gjermane dhe shqipe, Ipeshkvi i Kosovës, Mons Dodë Gjergji, tha. Është kjo një mundësi shumë e mirë për integrimin e komunitetit tonë në këtë vend, ndaj jam i sigurt që përmes një bashkëpunimi më të mirë përmes kësaj Qendre do të arrihen suksese edhe më të mëdha. Në vazhdim lidhur me Zonjën e Këshillit të Mirë foli Mons Lucjan Augustini. Të

pranishmëve iu drejtuan me përshëndetje edhe Reto Kaufman, Daniel Untermährer, Daniel Vasalli dhe Marco Schmid të cilët pasi shprehën falënderimin për bashkëpunimin shumë të mirë dhe punën e madhe që ka bërë misionari, Don Marjan Demaj, shprehën bindjen se në të ardhmen Qendra e re do të ndihmoi shumë më tepër në afirmimin e vlerave fetare, njerëzore e kombëtare në mes dy popujve.

Kori ynë këndoi disa këngë: Ave Maria dhe Jubilate Deo, të përcjellura me violinë nga Mark Ukaj, Gabriella Thaqi, dhe Kristina Komani, me flaut Ndue Thaqi dhe në piano Kristella Komani. Pastaj grupi i valltarëve Shqiponja, e cila vepron në kuadër të Misionit shfaqti një koncert me këngë e valle të bukura shqipe. Duhet veçuar sidomos tenorin e njohur Hil Thaçin e percjellur me piano nga bashkëshortja Arieta dhe solisten e re të talentuar, Leonora Berisha, këngët e të cilëve u mirëpritën me duartrokitje të gjata, duke krijuar një atmosferë të ngrohët e çaste gëzimi e hareje në sallën e bukur tashmë të Qendrës së re.

Në fjalën përmbyllëse, misionari ynë Don Marjan Demaj, duke falënderuar të pranishmit, tha se një sukses i tillë është arritur falë punëve dhe organizimeve të shumta që janë bërë në Misionin tonë. Kërkesa për një Qendër të tillë moderne është bërë vite më parë, mirëpo arriti të realizohet falë Zotit dhe njerëzve vullnetmirë. Këtë përuim po e bëjmë sonte, pikërisht në Ditën e Flamurit Kombëtar, ndaj shfrytëzoj nga rasti të gjithë shqiptarëve t'ua urrej këtë ditë të bekuar, me dëshirë që kudoherë të jemi të bashkuar dhe të jetojmë në paqe e dashuri të përhershme me njëri tjetrin.

Një falënderim i veçantë shkoi edhe për kuzhinierët vullnetarë të cilët kishin përgatitur një darkë solemne për të gjithë të pranishmit si dhe tortën e madhe me mbishkrimin e Misionit Katolik Shqiptar të Luzernit me të cilën u përmbyll kjo mbrëmje e shkëlqyeshme përuruese.

Mesha në kishën e shën Mëhillit

Të dielën, më 29 nëntor në kishën e shën Mihillit në Luzern

e cila nga tani do të jetë pjesë e Misionit tonë, në praninë e rreth 1000 besimtarëve u celebrua mesha shenjte e udhëhequr nga ipeshkvi i Kosovës mons. Dodë Gjergji në bashkë meshim me ipeshkvijtë tjerë dhe meshtarët don Marjan Marku, don Albert Demaj, don Ndue Ballabani, si dhe udhëheqësit e kësaj famulie Daniel Unterneher dhe don Marjan Demaj. Ata që në fillim të meshës falënderuan dhe u dëshiruan mirëseardhje mysafirëve dhe numrit të madh të besimtarëve që kishin ardhur në këtë gëzim të përbashkët për Misionin tonë, mysafirëve zviceranë, kryetarit të administratës për misionet të të huajve në kanton Luzern dhe kryetar i Shoqatës Pro Prishtina zotri Wili Blättler si dhe zotëri Fredi Isler Kryetarit të administratës për misionet të të huajve në kantonin e Zyrihut si dhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Mons. Doda në fillim të meshës ne gjuhën gjermane dhe shqipe falënderoi pjesëmarrësit dhe tha se ndihem shumë i lumtur që jam në mesin tuaj dhe mund të udhëheq këtë Meshë shenjte. Ai gjatë predikimit foli për kohën e Ardhjes si një kohë e veçantë për një përgatitje sa më të mirë për Krishtlindje, për vlerat që duhet të kemi si të krishterë dhe që kemi marrë nga vendlindja për t'i ruajtur dhe kultivuar tek brezat e rinj dhe apeloj që të jemi gjithnjë të bashkuar rreth Misionit që është në shërbim të besimtarëve.

Mbresëlënëse ishte paraqitja e dhuratave në meshë. Të rinjtë e Misionit tonë në veshje kombëtare nga tri anët e Kishës ofruan: bukën dhe verën, lulet dhe qiriun dhe portretin e madh të Zonjës së Këshillit Mirë që është edhe pajtorja e Misionit tonë. Këto dhurata ishin simbol, sepse bashkë me to ia paraqesim Zotit edhe jetën dhe njetet tona. Vlen të theksohet këndimi i bukur i korit të Misionit.

Para përfundimit të meshës, misionari ynë falënderoi të gjithë ata që kanë kontribuar për Qendrën e re, e cila edhe më mirë do t'i plotësojë kushtet për punë dhe për bashkimin e besimtarëve: Merita është e Zotit dhe e juaja të dashur vëllezër e motra që jeni mjaft aktivë në çdo pikëpamje dhe këtë e keni dëshmuar sa herë dhe po e dëshmoni edhe sot, kur



Mons. Lucjan Augustini, Mons. Dodë Gjergji dhe Mons. Zef Gashi



jëni në këtë numër kaq të madhe në këtë meshë shenjte. Një falënderim i veçantë për zotëri Wili Bletlär, që ishte shumë aktiv për gjetjen e qendrës së re. Atij ju dhurua një pikturë e bukur e të lumturës Nënës Terezë që u përcoll me duartrokitje.

Pastaj don Marjani falënderoi paraardhësit e tij, themeluesin e Misionit don Aleksandër Kolën, i cili me një angazhim të jashtëzakonshëm dhe me mund të madh ka krye nevojat shpirtërore për gjithë besimtarët në tërë Zvicrën. Pastaj don Marjan Markun, me angazhimin e të cilit u krijuan edhe dy Misione të tjera dhe ardhja e motrave, gjë që lehtësoi shumë punën e misionarëve duke

shtuar edhe efikasitetin e punës. Pastaj fjalën e mori edhe don Marjan Marku ish udhëheqës këtij Misioni në vitet 1999-2002, i cili përshëndeti të pranishmit, urrej për qendrën e re dhe falënderoi misionarin tonë dhe motrat për punën e madhe që bëjnë në këtë Mision.

Pas meshës për të gjithë në oborrin e bukur të Kishës u organizua një koktej në të cilin grupi i valltarëve "Shqiponja" me disa valle argëtoi të pranishmit. Në fund për mysafirët ishte e përgatitur dreka solemne.

(Përgatiti: Pjetër Gjoni)

Fenomeni "The Priests" (Meshtarët)

«Ne meshtarët, në krye të klasifikimeve në shtet të fesë» ("Benediktus" e cila i dedikohet viktimave të Kosovës)

Dy milionë kopje të disqeve të shitura, janë në faqet e para të revistave më të famshme dhe prestigjioze, të intervistuar nga kanalet më të shikuera dhe udhëtime nëpër botë. Është ky rezultati që ka dalë nga puna e këtyre tre meshtarëve nga Irlanda "The Priests" – meshtarët. Këta janë: Padre Martin O'Hagan, Padre Eugene O'Hagan dhe Padre David Delargy. Tre meshtarë irlandezë, të etiketuar si "new star" të muzikës dhe tani dalin me albumin e dytë të karrierës së tyre me titull: "Harmony", mes Bach-ut e Silent Night, një këngë për paqe në Irlandën e Veriut dhe "Benediktus", e cila i dedikohet viktimave të Kosovës. Por mbi talentin e tyre, është e nevojshme të shtojmë pyetjen, nëse ky sukses a e ka penguar misionin meshtarak të tyre. Kur na bëhet e ditur se edhe në pushime ata ndalojnë për të nënshkruar autografe e për të bërë foto me grupin që është duke e mahnitur botën e muzikës. Por përgjigjet e tyre i ikën çdo dyshimi: "Janë momente për të takuar njeriun, edhe kur na kërkojnë autografe, foto por na kërkojnë

edhe që të lutemi së bashku me ata. I shfrytëzojmë këto takime me njerëzit për ta kuptuar tjetrin dhe për t'iu përgjigjur tjetrit, dhe për të biseduar mbi fenë dhe Zotin".

(Tash e sjellim një intervistë të shkurtër, të marrë nga revista "Avenire", revistë e Konferencës Ipeshkvore Italiane, me famë kombëtare e ndërkombëtare.)

1. Kur e keni prezantuar albumin e parë, objektivi kryesor ishte "të ungjillëzosh nëpërmjet muzikës". A e keni arritur qëllimin?

Nuk dëshiroj të parashikoj, por përgjigjja është PO. Në mënyrën se sa kemi udhëtuar dhe nëpërmjet takimeve që kemi arritur t'i bëjmë me shume njerëz të ndryshëm në kërkim të një jete. Nganjëherë edhe persona, të cilët ishin duke prituri vetëm shytjen e fundit për t'iu kthyer Kishës.

2. Në misionin tuaj në famulli dhe detyra të tjera a është ndërjerë mungesa e prezencës tuaj?

Jo. Kontrata me Sony parashikonte të vetmin prioritet që është vetëm për pastoral. Ne jemi famullitar, punojmë edhe

në gjyjin kishtar. Promocionet e albumeve bëhen kur ne kemi kohë. Në vitin 2008, për të kuptuar, i kemi dedikuar vetëm një ditë pune në javë.

3. Ipeshkvi juaj nuk e gjykon këtë si të ishte diçka e tepruar?

Jo, përkundrazi është i lumtur, e konsideron këtë aktivitet si një zhvillim të detyrave ministeriale. Një vepër në një "famulli" më të madhe. E duke mbledhur fonde nëpërmjet koncerteve tona: ndihmojmë entet e ndryshme bamirësie, misionarët, të sëmurët, shkolla dhe të varfërit.

4. Në albumin e dytë që e keni kompunuar, keni zgjedhur vargje që i takojnë situatave të kohës bashkëkohore. E keni ndërjerë si detyrim?

Sigurisht. Na është e dukur e nevojshme të japim porosi të shpresës, lumturisë, faljes, haresë edhe ndaj ditëve tona. E duke kënduar një këngë kishtarë të shekullit të gjashtë "Shenjt, Shenjt", e kemi ndërjerë të arsyeshme t'i japim domethënie dhuratës që e kemi për muzikë: për ti thënë të gjithëve se edhe ne përmerjet veshitëse Ai, "Mbret i mbretërve", na ndihmon gjith-



monë. Është Ati ynë, pra ai i mbronë fëmijët e vet.

5. Por njerëzit e shekullit XI ju degojnë nëse flisni për një qetësi të mbrendshme edhe për pranimin e vdekjes?

Besojmë se është e nevojshme, në këto bote të shekullarizuar,

për keso koncepte. Ka lufta, dhe vdekja na paraqitet si kufi i mundesise për të kuptuar dhe na bene të frikësohemi. Por kemi parë se njerëzit kanë dëshirën e tyre, për fjalë që shkojnë përtej këtyre kufijve. Me një fjalë, e ndjejmë se njerëzit kanë nevojë dhe dëshirojnë të zbulojnë fenë e tyre.

Dimitri Medvedev më 3 dhjetor në Vatikan takoi Papën Benediktin XVI



Papa Benedikti XVI priti pasdite në Vatikan presidentin e Federatës Ruse Dmitrij Medvedev. Përpara këtij takimi kryetari i Këshillit Papnor për Bashkimin e të Krishterëve, kardinali Valter Kasper tha se presidenti Medvedev nuk vjen në Vatikan si ndërmjetësues i Kishës ortodokse ruse për dialogun me Kishën Katolike. "Pas shumë shekujsh të vështirë, marrëdhëniet ndërmjet Kishës katolike dhe Patriarkanës ruse janë përmirësuar. Ka patur shumë shkëmbime vizitash dhe kemi

qëndrime të njëjta mbi shumë probleme" iu shpjegoi gazetarëve kardinali Kasper. Kohët e fundit, vetë vendimi i Gjykatës së Strasburgut për heqjen e kryqit nga shkollat italiane ka shkaktuar indinjatë të thellë tek Patriarkana ruse duke e afruar atë edhe më shumë me Kishën Katolike. "Ky që një vendim që shkaktoi indinjatë tek të krishterët e të gjithë Evropës. Dhe në këtë pikë katolikët dhe ortodoksët janë të një mendimi." vijoi më tej kardinali Valter Kasper. Sidoqoftë për të arritur tek një takim i nivelit

të lartë ndërmjet dy kishave, ka ende shumë për të bërë. Më parë duhen kapërcyer disa probleme për të cilat ka pasur përplasje. Pikësëpari problemi i Ukrainës, ku pas rrëzimit të pushtetit sovjetik katolikët e rritit bizantin i morën me forcë Kishat që dikur kishin qenë të tyre, por që shteti komunist ua kishte konfiskuar dhe ia kishte dorëzuar Patriarkanës së Moskës. Kujtojmë se edhe në mars të vitit 2007, në Vatikan që pritur nga Papa presidenti rus i asaj kohe Vladimir Putin.

Barak Obama me Nobel për Paqe "Për të drejtuar botën drejt drejtësisë"

Paqja dhe drejtësia janë objektivi për të cilat duhet të angazhohemi në ditët e sotme: ishin këto temat të cilat i prononcoi presidenti Amerikan Barak Obama në marrjen e çmimit Nobel për Paqe. Ai ndër të tjera tha: "E pranoj këtë shpërblim me shumë falënderim dhe përvujtëri. Është një shpërblim që flet për aspiratat tona më të larta, e cila na fton përkundër të gjitha vështirësive në botë, ne nuk jemi të burgosurit e fateve tona. Veprimet tona e kanë një çmim dhe mundemi ta orientojmë botën drejt drejtësisë". Por gjatë pranimit të këtij shpërblimi nuk kanë munguar as protestat dhe kritikant ndaj Obamës pas vendimit se duhet shtuar numri i ushtarëve deri në 30.000 trupa në Afganistan e Irak. Është një moment i vështirë, ka thënë Obama, në raport mes paqes dhe luftës. "Paqja e vërtetë – tha Obama – nuk është vetëm një paqe e liri nga frika, por liri nga e drejta që i takon

secilit njeri. Nuk duhet të ekzistojnë vende, në të cilat rriten dhe edukohen fëmijë në urrejtje dhe vrasje. Mungesa e shpresës e shkatërron një shoqëri e një popull". Ndër të tjera, Obama ka përkujtuar shumë figura që e kanë pranuar këtë çmim kaq domethënës dhe obligativ si Martin Luther King dhe Nelson Mandela.



Kryepeshkopi Anastas u takua me Papa Benediktin XVI

Kryepeshkopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, Fortlurturia e tij Anastasi, për të parën herë në historinë e Kishës autoqefale shqiptare e zhvilloi një vizitë zyrtare në Vatikan, me ftësë nga Papa Benedikti XVI.

Ndërsa më datë 9 dhjetor, Kryepeshkopit, prof. sr. Anastasi, iu dorezua në Napoli titulli "Doktor Honoris Causa" në teologji, për kontributin e gjatë dhe intensiv shkencor, misionar dhe baritor, nga Universiteti Pontifikal i Italisë Meridionale.

Gjithashtu, Fortlurturia e tij është ftuar nga Kryekancelari i këtij fakulteti, Arqipeshkvi i Napolit, Kardinal Kreshenzio Sepe, që të mbaje fjalën kryesore Lectio Magistralis me rastin e hapjes zyrtare të vitit të ri akademik, në Aula Magna të seksionit "San Tomaso".

Fjalim i Papës Benedikti XVI në audiencën me Fortlurturinë e Tij, kryepeshkopin Anastasios Janullatos:

(...) Jam i gëzuar t'i uroj vëllazërisht mirëseardhjen Fortlurturisë Suaj dhe përfaqësuesve të tjerë të shquar të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, të cilët ju shoqërojnë sot. Kujtoj me mirënjohje, pavarësisht nga rrethanat e trishtuara, takimin tonë në funeralin e Papës së ndjerë Gjon Pali II. Kujtoj gjithashtu me kënaqësi se edhe vetë Paraardhësi im pati rastin t'ju përshëndes në Tiranë, gjatë Vizitës së tij Apostolike në Shqipëri.

Siç dihet, Iliria e pranoi Ungjillin që nga kohët apostolike (cf. Vap 17:1; Rom 15:19). Që nga ajo kohë, mesazhi shëlbues i Krishtit ka sjellë frytë në atdheun tuaj deri në ditët tona. (...) Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, të krishterët në Shqipëri, si ortodoksë ashtu edhe katolikë, e mbajtën fenë gjallë pavarësisht nga regjimi atëist jashtëzakonisht shtypës dhe armiqësor; dhe, siç dihet, shumë të krishterë paguan me jetë për atë fe. Rënia e atij regjimi i hapi rrugën rindërtimit të bashkësieve katolike dhe ortodokse në Shqipëri.

(...) Që nga fitimi i lirisë, Kisha Ortodokse në Shqipëri ka marrë pjesë frytshëm në dialogun teologjik ndërkombëtar ndërmjet katolikëve dhe ortodoksëve. Impenjimi juaj për këtë pasqyron qartë marrëdhëniet vëllazërore ndërmjet katolikëve dhe ortodoksëve në vendin tuaj dhe frymëzon krejt popullin shqiptar, duke treguar se si është e mundur që të krishterët të jenë në harmoni.

Në këtë dritë, do të bënim mirë të nënvizonim elementet e fesë, që janë të përbashkëta për Kishat tona: besojma e përbashkët nikeane-kostandinopo-

jane; i njëjti pagëzim për faljen e mëkateve dhe për t'u bërë një me Krishtin e me Kishën; trashëgimia e Konkileve të para Ekumenike; bashkimi i vërtetë, megjithëse jo i përsosur, që përjetohet dhe dëshira e përpjekjet e përbashkëta për të vazhduar rrugën e nisur. Dua të përmend këtu dy nisma të rëndësishme në Shqipëri: ngritjen e Shoqërisë Biblike Ndërkonfesionale dhe krijimin e Komitetit për Marrëdhëniet Ndërfetare. Këto janë përpjekje të kohës për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin e dukshëm, jo vetëm ndërmjet katolikëve dhe ortodoksëve, por edhe ndërmjet të krishterëve, myslimanëve e bektashinjve.

(...) Të jeni të sigurt se ne, nga ana jonë, do të bëjmë çështje e mundur për dëshminë e përbashkët të vëllazërimit e paqes dhe për të vazhduar me ju impenjimin e përtëritur për bashkimin e Kishave tona, duke iu bindur Urdhërimit të ri të Zotit tonë.

Fortlurturia Juaj, në këtë frymë bashkimi, është kënaqësi për mua t'ju uroj mirëseardhjen në qytetin e Apostujve Pjetër e Pal.

Përshëndetja e Kryepeshkopit të Tiranës, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë, Anastasios Janullatos drejtuar Papës Benedikti XVI:

(...) Sot është një ditë historike për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Është hera e parë që një delegacion nga Kisha jonë viziton Kishën e Romës dhe ka nderin e kënaqësinë të komunikojë personalisht me Shenjtërinë Tuaj; të cilin e njohim si mendimtar të thellë, teolog të shquar, mbrojtës të paqes e të drejtësisë, kampion solidaritetit ndërmjet popujve dhe udhëheqës krijues kishar.

Në shekullin e 20-të, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë pësoi një nga persekutimet më të tmerrshme. Që nga viti 1944 deri më 1967, ai mori formën e zakonshme të shtypjes që pësuan të gjitha Kishat në Evropën Lindore. Por, që nga viti 1967 deri më 1990, Kisha në Shqipëri u çua me të vërtetë në "portat e Ferit". Kushtetuta ndaloi çdo shprehje fetare dhe, sëbashku me persekutimin e paqësuar, solli shkrirjen e plotë të Kishës.

Me hirin e fuqinë e Zotit, Kisha jonë ka rilindur dhe ka bashkuar të gjithë të krishterët ortodoksë në Shqipëri, pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike. Ajo është rritur sistematikisht; duke forcur jetën liturgjike, duke u lutur, duke bërë katekizëm e duke përkthyer e botuar literaturë të krishterë; duke formuar e duke shquar mësë 140 kler-

ikë; duke ndërtuar 145 kisha të reja; duke restauruar 70 të tjera e duke riparuar 160 kisha dhe qendra kishtare; e mbi të gjitha duke bërë përpjekje këmbëngulëse për ta afruar brezin e ri me Krishtin.

(...) Do të doja të kujtoj se para se të pranoja misionin e Primatit të Kishës së Shqipërisë, pata kënaqësinë, në fund të viteve 1960, t'ju njihja në një tryezë të rumbullakët mbi misionin në Marburg. Më vonë, si profesor i Universitetit të Athinës, ju kam takuar në Mitingun e teologëve ortodoksë dhe katolikë romakë në Qendrën Inter-ortodokse në Athinë, që pati si temë "Das Sakrement der Waihe" (Qershor 1973). Që atëherë, kam ndjekur me interes të madh shkrimet Tuaja të thella, përpjekjet dhe luftën për t'u siguruar që drita e Krishtit, drita e dashurisë dhe e shpresës të rrezatojë krejt botën.

(...) Që nga ringjallja e saj, Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, me këtë në mendje, ka marrë pjesë në dialogun ndërmjet kishave dhe natyrisht në dialogun ndërmjet ortodoksëve dhe katolikëve romakë. Pa nënvlefësuar vështirësitë e kësaj ruge, ne jemi të sigurt se përpjekja aktive për të kapërcyer ndarjet është plotësimi i vullnetit të Kreut të Kishës, Zotit tonë Jezui Krisht; i cili në çastin më të vështirë para Mundimeve, u lut që ata që besojnë në Të "të jenë një" (Gjoni 17:21). E njëkohësisht, kjo u përgjigjet edhe kërkesave të kohës sonë që na kërkojnë drejtësi, bashkëjetesë në harmoni dhe solidaritet me të gjithë njerëzit. Sigurisht që problemet mbeten dhe do të duhet gjithë reflektimi, dëshira e sinqertë për të kërkuar të vërtetën, mendimi kritik, shndritja dhe hiri i Zotit për t'i zgjidhur.

Në fillim të shekullit të 21-të, përvoja e tmerrshme e 11 shtatorit 2001 na kujton rrezikun e jashtëzakonshëm që e kërcënon njerëzimin nga ringjallja e fanatizmeve fetare. Që atëherë, janë shtuar nismat jo vetëm për paqen në botë, por edhe për dialogun ndërfetar, me qëllim që të mbështetet rruga e paqes sipas traditave e bindjeve fetare. Kemi ndjekur me interes e vëmendje të madhe ndërhyrjet e Shenjtërisë Suaj, nismat dhe veprimtarinë Tuaj në këtë fushë kritike siç është dialogu ndërfetar. Në Shqipëri, në veçanti, që nga kthimi i lirisë së fesë, bashkësitë kryesore fetare, ortodoksët, katolikët dhe myslimanët, si sunitët ashtu edhe bektashinjtë, kanë krijuar jo vetëm një atmosferë tolerancë fetare, por diçka edhe më të rëndësishme: respektin e ndërsjellë, mbështetjen për njëri-tjetrin dhe bashkëpunimin krijues. Kjo ka ndihmuar në përparimin dhe zhvillimin paqësor të krejt vendit.



(...) Të mos shqetësohemi për të ardhmen. Sepse ne e shohim se e ardhmja i takon Krishtit. Sepse Jezusi është Ai "që është dhe që ishte e që do të jetë; i Gjithpushtetshmi". E Ai po vjen përsëri nga e ardhmja!

Ne e dimë Shenjtëria Juaj se përmes shërbimit tuaj të gjatë akademik e kishar, keni

mbështetur, siç vazhdoni ta bëni, fenën me këtë siguri unike, me mendimin tuaj të thellë, me bujarinë e shpirtit, me perspektivën profetike. Nga Kisha e Shqipërisë, që ka vuajtur aq shumë, ju lutem pranoni një falenderim të ngrohtë për nderin e audiencës së sotme dhe urimet tona më të përzemërta e të sinqerta.

Marrëveshja e Bashkimit Evropian mbi Klimën: 7,2 miliardë dollarë për vendet e varfra

Mbi 7 miliardë dollarë nga viti 2010 deri në 2012 do t'i jenë në dispozicion të vendeve më të prekura nga vështirësitë e klimës. Kjo është zgjedhja nga Bashkimi Evropian për t'i ndihmuar vendeve me probleme ekonomike për të reduktuar ndotjen e ambientit. Ndërsa 21 miliardë dollarë të tjera do të shpenzohen mbrenda Evropës për tri vitet e ardhshme për të zbritur për 30 % nivelin e gazrave helmues për shëndetin e njeriut dhe arsya e dytë ngrohja e globit. Ndërsa Greenpeace ka kërkuar deri në 110 miliardë dollarë për t'i dalur në ndihmë dhe për ta shpëtuar botën nga kanosjet e natyrës, të cilat i ka nxitur njeriu me shkencën dhe prodhimin e pa kontrolluar sidomos të armëve atomike dhe një ndër shkaqet më të rrezikshme janë edhe eksperimentet që janë bërë me këto armë atomike, biologjike dhe kimike, të cilat janë

shkaku i shumë sëmundjeve bashkëkohore.

Sipas ekspertëve ngrohja globale është rritur për 2 gradë Celcius në tërë planetin.

Pozicione dhe mendime të ndryshme dhe të kundërta kanë dalë nga konferenca, por shumë kapituj duhen të shkruehen ende për të zhbllokuar bllokimet që janë ndërmjet shteteve dhe frikës reciproke me kanosjet të destabilitetit në gjitha kontinentet. Ndërsa Kina e India janë duke e punuar një planprogram alternativ për sa i përket klimës globale, por shumë shtete e bëjnë të ditur se nuk dëshirojnë të marrin pjesë në këtë program, sepse nuk dëshirojnë të zvogëlojnë prodhimin industrial edhe pse kanë efektet të rrezikshme, por të gjithëve iu bëhet e detyrë obligimin që e kanë me nënshkrimin e protokollit të paktit të Kyotos, e cila skadon në vitin 2013.

Përgatiti: Don Pal/TUNAJ

Toma apostull

■ PËRGATITI:
Don Marjan MARKU

Shën Toma bën pjesë në grupin Apostujve të cilët i ka zgjedhur vetë Zoti ynë Jezu Krishti. Ai përmendet tek të katër ungjilltarët dhe në tre ungjilltarët e parë përmendet pranë Mateut (krah. Mt 10,3; Mk 3,18; Lk 6,15), ndërsa në Veprat e Apostujve gjendet pranë Filipit (krah. Vap 1,13). Emri i tij rrjedh prej gjuhës hebraishte, »ta'am«, që do të thotë »çift« apo »binjak«. Në realitet, në ungjillin e Gjonit shumë herë quhet edhe me emrin grek »Didymus« (krah. Gjn 11,16; 20,24; 21,2), që do të thotë »binjak«. Përse Toma quhet me këtë emër nuk e është e qartë.

Ungjilli i katërt në mënyrë të posaçme na sjell disa informata të cilat e karakterizojnë personalitetin e tij. Informata e parë është reagimi i tij ndaj apostujve të tjerë, kur Jezusi gjendej në një moment kritik të jetës së tij, kur ishte duke shkruar në Betani për ta ngjallur Lazërin. Ishin në udhëtim për në Jerusalem, nxënësit e ndiqnin edhe pse me frikë (krah. Mk 10,32). Atëherë u tha Toma nxënësit të tjerë: »Të shkojmë edhe ne të vdesim bashkë me të« (Gjn 11,16). Ky vendim i tij për të shkruar pas mësuesit është me të vërtetë një shembull i madh për ne dhe për të gjithë të krishterët. Këtu Toma shpall dorëzimin e tij të tërësishtë dhe besnikërinë e tij të plotë për Jezusin duke qenë i gatshëm që ta ndaj fatin e tij me fatin e Jezusit dhe të jetë

i gatshëm që ta jap edhe provimin e fundit duke e ndarë edhe vdekjen me Jezusin. Për Tomën gjëja më e rëndësishme është që mos të ndahej prej Jezusit. Në përgjithësi, ungjilltarët i përdorin fjalët për apostujt »me shkua pas tij«, për të sjell në pah kuptimin: se aty ku shkon Jezusi, atje duhet të shkojnë edhe nxënësit e tij. Në këtë kuptim jeta e të krishterëve duhet të përputhet me jetën e Jezusit, duhet të jetë një jetë e cila duhet të jetohej së bashku me të. Shën Pali shkruan diçka të ngjashme atëherë kur iu shkruan të krishterëve në Korint: »ju jeni në zemrën tonë dhe se vdesim e jetojmë së bashku« (2 Kor 7,3). Siç ka ndodhur në mes të apostujve dhe të krishterëve të parë ashtu duhet të ndodh edhe sot në mes të krishterëve dhe Jezusit: duhet me qenë të gatshëm të vdesim së bashku, të jetojmë së bashku, të banojmë në zemrën e tij siç banojnë edhe ai në zemrën tonë.

Një lajm tjetër mbi Tomën e gjejmë në lajmin e darkës së fundit. Këtu pasi që Jezusi i lajmëroi apostujt e tij për vdekjen që e pret, Jezusi u tregoi se po shkon për të përgatitur një vend për apostujt, që aty ku është ai të vijin edhe apostujt dhe u tha: »Ku shkoj unë, ju e dini rrugën« (Gjn 14,4). Këtu Toma mori fjalën dhe tha: »Zotëri – Ne s'dimë kab po shkon. Si, pra, mund ta dimë udhën?« (Gjn 14,5). Me këtë pyetje Toma bie relativisht në një pikë të ulët të dije, por në këtë pyetje Jezusi përgjigjet me fjalët e njohura: »Unë jam Udhë, e Vërteta dhe Jeta« (Gjn 14,6). Këto fjalë janë drejtuar për Tomën në atë kohë por

vlejnë edhe për të gjithë kohërat dhe për të gjithë ata të cilët i lexojnë apo i dëgjojnë këto fjalë. Ne duhet ta kuptojmë se Jezusi flet edhe me ne siç ka folur edhe me Tomën. Po ashtu edhe ne kemi të drejtë t'i drejtohem Jezusit për shpëtim. Shpeshherë ne nuk mund ta kuptojmë Jezu Krishtin dhe kemi guxim të themi: Nuk po të kuptoj o Zot, më dëgjo, më ndihmo që të kuptoj! Në këtë kuptim, me një guxim të tillë, me një mënyrë të vërtetë të lutjes e cila është bisedë me Jezusin, ne e shohim kufizimin e kuptimit tonë dhe në të njëjtën kohë tregojmë besimin tonë në të dhe në këtë drejtim fitojmë ndriçimin prej së larti për t'i kuptuar gjërat të cilat nuk mund t'i kuptojmë me mendjen tonë të kufizuar.

Të gjithë e njohim edhe skenën e Tomës i cili nuk beson, e cila kishte ndodhur tetë ditë pas ngjalljes. Në momentin e parë nuk besonte se është lajmëruar Jezusi në momentin kur ai nuk ishte me apostujt dhe kishte thënë: »Pa e parë në duart e tija vrazhën e gozhdave e pa e vënë gishtin tim në vend të gozhdave; pa e shtirë dorën time në krahavarin e tij, kurrë nuk besoj.« (Gjn 20,25). Nga thelbi i këtyre fjalëve shihet se nuk ishte e rëndësishme prania e Jezusit por shumë më tepër ishin të rëndësishme vrazhat e tija.

Toma mendon, për të identifikuar Jezusit duhet parë shenjat, vrazhat e tija për të dëshmuar dashurinë e tij. Duke i parë dhe duke i prekur këto shenja ai nuk mund të mashtrohet. Siç e dimë, Jezusi iu lajmërua nxënësit të tij të ditë më vonë dhe kësaj radhe ishte edhe Toma me ta. Jezusi iu drejtua Tomës duke i thënë: »Shtjere gishtin tënd këtu e qe, shibi duart e mia! Ma jep dorën tënde e shtjere në krahavarin tim dhe mos ji njeri që s'beson, por besimtar!« (Gjn 20,27). Në këto fjalë Toma reagon me besimin më të thellë që mund ta gjejmë në Besëlidhjen e Re: »Zotëria im dhe Hyji im!« (Gjn 20,28). Nga këto fjalë Shën Augustini shkruan: Toma, »pa dhe preku njeriun, dëshmojë fenë e tij në Hyjin të cilin e pa dhe e preku. Por çka pa dhe preku, ndikoj që të besojë në atë që më parë dyshonte« (In Ioann. 121,5). Ungjilltari vazhdon me një fjalë të fundit të cilën Jezusi ia drejtoi Tomës: »Pse po më sheh, po beson.« (Gjn 20,29). Kjo fjalë mund të përdoret edhe në kohën e tashme: Lum ata që nuk shohin dhe prapë besojnë (Krah. Gjn 20,29). Këtu Jezusi shtron një princip thelbësor për



Emri i tij rrjedh prej gjuhës hebraishte, »ta'am«, që do të thotë »çift« apo »binjak«. Në realitet, në ungjillin e Gjonit shumë herë quhet edhe me emrin grek »Didymus« (krah. Gjn 11,16; 20,24; 21,2), që do të thotë »binjak«.

të krishterët, të cilët do të vijin pas Tomës, pra për të gjithë ne. Është shumë interesante për të parë shpjegimin e Tomës tjetër, teologut të madh të mesjetës, Toma nga Akvini i cili e komentonte lumturinë të cilën na sjell Lluka Ungjilltar: »Lum sytë që shohin çka po shihni ju!« (Lk 10, 23). Ndërsa Shën Toma e komenton: »Shumë më tepër fiton ai i cili beson duke mos parë se ai që ka parë dhe beson« (In Ioann. XX lectio VI § 2566). Përfundimisht letra e Hebrenjve nën kapitlen e fesë e definon titullin e thirrjes në një formë të gjatë duke analizuar patriarkët të cilët kishin fenë në Hyjin duke mos e parë plotësimin e premtimit, besimin si: »një mënyrë pasjeje të sendeve që shpreson, mjet të njiher sendet që nuk shihen« (Hebr 11,1). Rasti i Tomës apostull së paku për ne është për tri gjëra i rëndësishëm: së pari, sepse na ngushëllon në mos sigurinë tonë, së dyti, sepse na tregon se çdo dyshim i pasigurt mund të na sjell deri tek drita, dhe përfundimisht, fjalët e drejtuara Tomës na përkujtojnë në kuptimin e rritjes në fe dhe na japin guxim që ti mbesim besnikë Jezusit në vështirësitë

tona të cilat i takojmë gjatë rrugës sonë tokësore.

Dhe një rast të fundit mbi Tomën e gjejmë tek ungjilli i katërt, ku ai ishte së bashku me nxënësit tjerë në breg të detit të Tiberiadit dhe ishin përgatitur për të zënë peshk (Krah. Gjn 21,2). Në këtë vend ai ceket menjëherë pas Pjetrit: një lajm i cili tregon rëndësinë e tij i cili kishte për bashkësinë e të krishterëve të parë. Në emër të tij janë shkruar aktet e Tomës dhe ungjilli i Tomës, të dyja janë shkruar apokrifë të cilat janë shumë të rëndësishme për studimet e fillimit të krishterimit. Përfundimisht ta përkujtojmë se sipas një tradite të lashtë, Toma kishte ungjillëzuar Sirinë dhe Persinë (kështu dëshmon Origeni i cituar nga Eusebius prej Caesarea, Hist. ecl. 3,1), dhe pastaj kishte arritur deri në jug të Indisë (krah.. Aktet e Tomës 1-2 und 17 ff.). Më këtë perspektivë misionare po e përfundojmë edhe këtë persiatje të sotme me një dëshirë, që shembulli i Tomës ta forcojë përherë e më tepër fenë tonë në Jezu Krishtin, Zotin dhe Hyjin tonë. Amen.



“Vallë, a nuk është ky Jezusi, biri i Jozefit?” (Gjn 6, 42)

■ SHKRUAN:
Atë Bernard Caruana O.P.

Jozefi: Njeriu i Drejtë

Normalisht, nuk ekziston as ndërmjet të krishterëve të mirë, një ide dhe një koncept mjaft i saktë për shën Jozefin. Ndoshta kjo varet nga fakti që Ai është aq afër Jezusit dhe Marisë, që përhapin përreth tyre shumë dritë, sa që nxjerrin në plan të dytë shën Jozefin dhe është, për këtë arsye, që të shumtën i hedhin vetëm një shikim dhe, është prapë shumë nëse arrihet kjo.

Ndodh, përkritazi me këtë një fenomen i çuditshëm dhe gati i pakuptueshëm për sa i përket figurës së këtij Shenjti. Qëndrojmë të habitur dhe të mrekulluar përballë zellit apostolik të shën Palit ose të serafinit të dashurisë së Shën Françeskut nga Asizi, entuziazmi në kërkimin e së Vërtetës së Shën Dominikut ose driturisë së Shën Tomë Akunit, apo thjeshtësisë soditëse të Shenjtes Terezë e Jezusit Fëmijë dhe më pas jemi indiferentë ose gati, përpara figurës sipër-njerëzore të Shën Jozefit.

E pra, ky Shenjt i madh, mund ta themi me siguri, mbledh në vetvete, në gradën maksimale dhe të paarrtshme të gjitha virtutet, bukuritë dhe cilësitë që shohim të pranishëm në këta Shenjtë që kemi përmendur. Për shembull, kështu pohon Shën Gregori Nazianzen: “Hyji i ka përqendruar në Shën Jozefin të gjitha shkëlqimet e të gjithë Shenjtëve”. Të ndalem në çast mbi këtë, përgjigjja që mund t’i japim vetes është që Shën Jozefi nuk është i njohur

dhe i dashur ashtu siç e meriton, pasi nuk studiohet mjaftueshëm dhe mbi të gjitha i propozuar neve të krishterëve.

Mund të bëjmë eksperiencën e një zbulimi të mrekullueshëm dhe shpirti ynë mund të ketë gëzim të madh, duke soditur bukuritë e brendshme dhe së bashku thesaret, virtutet, që të marra si shembull, do ta bënin më të shpejtë ecjen tonë shpirtërore dhe si rrjedhojë do të na e bënte më të lehtë jetën e çdo dite.

Çfarë dimë për Shën Jozefin?

Jozefi në Ungjijtë përkufizohet si njeri i drejtë, njeri bindjeje dhe besimi në Hyjin në heshtje. Dhëndër i Shenjtës Mari dhe baba kujdestar i Jezu Krishtit. Informacionet e pakta për këtë figurë të madhe, i gjejmë në Ungjijtë, në veçanti në Ungjijtë e quajtur të fëmijërisë, të Shën Mateut, e të Shën Lukës, edhe pse pak të besueshme i gjejmë të shumta në Ungjijtë Apokrifë, të cilët ama patën shumë rëndësi në zhvillimin e traditave dhe të zhvillimeve artistike.

Ungjilltarët Sh. Mateu dhe Sh. Luka përkujtojnë kur e paraqesin Sh. Jozefin si pasardhës të fisit të Davidit. Por ndryshojnë në gjenealogji, duke ndjekur secili një seri antenatësh të ndryshëm, që në Sh. Mateun arrijnë te Jozefi nëpërmjet Jakobit (1,16), ndërsa në Sh. Lukën nëpërmjet Elisë (3,23). Që nga lashtësia janë bërë shumë tentativa për të arritur një pajtim përfundimtar dhe të gëzueshëm të çështjes, që megjithatë duhet konsideruar akoma e hapur duke mos mundur të gjenet asnjë zgjedhje për t’i dhënë titullin e traditës së vërtetë.

Kuptimi i gjenealogjisë është, megjithatë, të futet Jezusi në historinë njerëzore, duke dokumentuar që Fjala, e cila është pranë Atit, është bërë bir i Adami, njeri si ne, nëpërmjet fisit të Abrahamit dhe familjes së Davidit.

E dimë që Sh. Jozefi kishte një vëlla me emër Kleofa. Nazaretit është vendi ku Sh. Luka (1,26) na e paraqet të martuar me një virgjër me emër Maria, e cila “e hijesuar” nga Shpirti Shenjt ngjiz Jezusin. Për arsye të një urdhri të Cezar Augustit, që urdhëron një regjistrim, familja shkon në vendin e origjinës, Betlehemi, ku lind Jezusi (2, 1-7). Bëhet fjalë për regjistrimin që filloi gjatë legatës së Kuiritit në vitet 11-8 para Krishtit, me ras-

tin e luftës që drejtoi në Cilici kundër Omonadensëve.

Ndërsa Shën Luka, ungjilltari i Marisë, tregon ngjizjen dhe lindjen e birit të Virgjërës, Shën Mateu, që shkruan për hebrenjtë, referon lindjen e Mesisë, të Jezusit, birit të Davidit. Për këtë qëllim ai e fillon Ungjillin e tij me fjalët: “Breznitë e Jezu Krishtit, të birit të Davidit, të birit të Abrahamit.” (rr. 1) dhe tregon që Jezusi rezulton biri i Davidit nëpërmjet “Jakobit i lindi Jozefi, fati i Marisë, prej së cilës lindi Jezusi që quhet Krisht” (rr. 16). Shën Mateu tregon realizimin e kësaj lindjeje të ligjshme, të pohuar nga gjenealogjia: “Lindja e Jezu Krishtit ndodhi kështu: Maria, nëna e tij, pasi u fejua me Jozefin, para se të banonin së bashku, u gjend shtatzënë-

në për virtut të Shpirtit Shenjt” (rr. 18), duke rimarrë kështu rr. 1.

Synimi i Shën Mateut që të provojë “atësinë” ligjore të Shën Jozefit vazhdon në tregimin e rr. 18-25 ku, mbetet përjashtimi i tij nga ngjizja e Jezusit (rr. 18, 25), Shën Jozefi gjen në mesazhin e Engjëllit zbulimin e detyrës së tij. Në fakt, pasi Shën Mateu kishte pohuar që Maria “nëna e tij [...] u gjend shtatzënë për virtut të Shpirtit Shenjt,” lexuesit izraelit, që nuk kishte vështirësi të pranonte mrekullinë, i paraqitej nën planin juridik, çështja e rëndë e trashëgimisë së fronit të Davidit nga ana e fëmijës, edhe pse bir i një virgjëreshë.

Kjo vështirësi reflektohet nga Shën Mateu mbi planin psikologjik në dyshimin e Shën



“Fëmijët nuk i përkasin martesës, vetëm sepse të lindur nëpërmjet saj, por sepse në martesë prano-hen dhe edukohen” Shën Tomë Akvini”



Jozefit: duhet ta mbajë Marinë, që ka ngjizur këtë fëmijë ndërsa ishte e tij, ose të linte, nga momenti që ajo nuk i përket më, pasi askush nuk mund të marrë atë çka nuk i jepet nga qielli?

Edhe pse Shpirti Shenjt është autori i ngjizjes, Shën Jozefi ka një detyrë për të pëmbushur. Sepse "duhet të jetë si baba" për fëmijën që ai, bir i Davidit, të marrë me vete, Nënë e Hyjit, me gjithë ngjizjen e saj virgjërore. Jezusi është bir i Davidit sepse vetë Shën Jozefi është i thillë. Me forcën e titullit të "bir i Davidit" Engjëlli i jep detyrën të marrë Marinë dhe Birin e saj, sepse nëse ai nuk është asgjë në ngjizje, është gjithçka në lindjen ligjore. Pas të ditës nga lindja e Fëmijës, pëmbushet mbi të riti i rrethprerjes dhe iu vendos emri Jezus.

Ndërsa në Lajmërin Shën Luka i jep Zojës detyrën t'i vendosë Fëmijës emrin: "Ja, do të mbetesh shtatzënë e do të nxjerrësh në dritë një djalë e ngjitja emrin Jezus" (1,31), në momentin e vendosjes së emrit përdor një formë jovetore: "Kur u mbushën tetë ditë për të rrethprerë Foshnjën, ia ngjiten emrin Jezus, siç e quajti engjëlli para se të zihet në kraharor" (2, 21). Ndërsa Shën Mateu thotë qartë që Shën Jozefi e quajti Jezus.

Pas dyzet ditësh nga lindja, Shën Jozefi e shoqëron Marinë dhe Jezusin në Tempullin e Jeruzalemit në respektim të normave të Ligjit, dëgjon i mrekulluar atë që Simeoni thotë për Jezusin dhe merr bekimin (Lk 2, 22-38).

Bën pjesë në tregimet e Shën Mateut vizita që Mbretërit i bëjnë në Betlehem Fëmijës dhe mungesa e kthimit të tyre të Herodi me rezultat në shtonte dyshimet dhe zemërimin dhe ta detyronte Familjen e Shenjtë të ikte drejt Egjiptit (2, 1-15).

Shën Mateu, që kishte zgjedhur me tregimin e dyshimit të Shën Jozefit vështirësinë juridike të atësisë së tij ligjore dhe kështu i kishte besuar, me të drejtë, këtë "biri të Davidit" detyrën të merrte Marinë dhe Birin e saj, na e tregon tani në ushtrimin e të drejtave të tij dhe të funksioneve të tij si Kryetar të Familjes së Shenjtë. Engjëlli i shfaqet atij. Atij i komunikohet destinacioni. Atij do t'i zbulohet data e kthimit në atdhe.

Shën Jozefi është Kryetari i pakundërshtueshëm i shtëpisë së tij ku gjithçka i nënshtrohet: "Çohu, merre fëmijën dhe të ëmën e tij e ik në Egjipt" (Mt 2, 13). Dimë akoma nga Shën Luka që Shën Jozefi zakonisht shkonte me familjen çdo vit në Jeruzalem për Pashkë (2, 41) dhe pikërisht në këtë rast Jezusi dymbëdhjetëvjeçar mbeti, në padijeni të prindërve, në qytet, duke iu shkakuar atyre një vuajtje të madhe në kërkimin e ankthshëm të zgjiatur tre ditë (rr. 42-50). Është akoma Shën Luka që karakterizon gjithë jetën e Jezusit në Nazaret me shprehjen "i u bindje" atyre që në rr. 48 ungjilltari kishte treguar si babai dhe nëna e tij (rr. 51).

Dimë gjithashtu që puna e Shën Jozefit ishte ajo e τέκτων, e

“Edhe pse ai nuk ishte babai i tij, pati për Jezusin, për një dhuratë të veçantë qiellore, gjithë dashurinë natyrore, gjithë kujdesin e përzemërt që një zemër babai mund të njohë”.
Papa Piu XII

përthyer nga Volgata me *faber*. Përgjithësimi i termit e shtrin në një shumicë aktivitetesh materiale. Apokrifët e përshkruajnë si zejtar plugjesh dhe zgjedhash, zanat që Shën Justini i jep edhe Jezusit. Për të njëjtin aktivitet të ushtruar mbi dru (zdrukthëtar, karpentier) janë interpretimet e versione të tjera.

Etërit në përgjithësi kanë pasur pak vëmendje, shpesh vetëm rastësisht për Shën Jozefin në shkrimet e tyre, kur e kërkonte teksti ungjillor që ata ishin duke paraqitur. Disa prej tyre u ndikuan nga apokrifët, duke gjetur aty një mbështetje të thjeshtë në mbrojtjen e virgjërisë së përjetshme të Marisë.

Megjithatë, takojmë disa Etër që shpallin dinjitetet e tij të larta, duke kërkuar hire të veçanta për atë që është dhëndri i Marisë dhe baba kujdestar i Jezusit.

Shën Jeronimi ka qenë i pari që e ka ngritur zërin për të mbrojtur virgjërinë e Shën Jozefit. Shën Agustini e ka ndjekur me vonë Shën Jeronimin. Dallohet në të lartësuarit e atësisë së Shën Jozefit dhe mbrojtjen e bashkimit të vullnetit të burrit dhe të gruas.

Shën Tomë Akuini ka tri pohime që formojnë bazat e teologjisë së Shën Jozefit: 1) martesë e vërtetë dhe e përkryer mes Shën Jozefit dhe Shenjtes Mari, për sa i përket esencës dhe përkryeshmërisë së parë, jo ama për sa i përket përdorimit; 2) virgjëri e përkryer e ruajtur nga Shën Jozefi gjatë gjithë jetës; 3) kusht pastërtie qoftë në Shenjtën Mari qoftë në Shën Jozefin, të kushtëzuar para martesës, absolute më pas.

Në konfirmim të sa është paraqitur më sipër, të shohim se çfarë na thotë Shenjtëri të tjerë rreth atij virgjëror të Jezusit.

I pari që ka mbledhur me rregull dhe me metodë, aq sa më mirë ishte shkruar për Shën Jozefin, është domeni i devotshëm dhe i ditur Izidori i Izolanit (1522), i cili na thotë që "Shën Jozefi mblodhi në vetvete cilësitë e nëntë koreve të engjëjve".

Po të na ishte dhënë hiri të hynim në brendësinë e këtij shenjt, do të gëzonim duke parë ndjenjat dhe me çfarë bukurie Zoti e ka zbuluar zemrën e Atij që duhet të ishte siç thonte Shën Bernardi "ngushëllimi i ëmbël i Nënës së tij, rojtar i duhur i njerëzimit të saj, besniku dhe i vetmi bashkëpunëtor në tokë të të madhit dhe të mistershmit projekt të tij: MISHËRIMI SHËLBUES".

Por përveç Shën Bernardit, edhe Shenjtja Tereza e Avilës shprehet në "Autobiografinë" e saj në kapitullin VI, ku thotë: "do të doja të nxisja të gjithë që të jenë të devotshëm ndaj këtij shenjt shumë të lavdishëm. Për eksperiencën e madhe që kam për të mirat që na nxjerr nga Hyji, nuk kam njohur kurrë një person që t'i jetë i devotshëm dhe ta nderojë në mënyrë të veçantë dhe që të mos ketë parë më pas të ketë si avantazh virtyte, pasi Ai iu bën shumë mirë shpirtit dhe i rekomandohen Atij".

Shën Jozefi, baba kujdestar i Jezusit

Është në Shën Jozefin një raport i vërtetë atëror ndaj Jezusit, themeli juridik i të cilit ndërtohet nga kontrata martesore të Sh. Jozefit dhe Marisë e për-bashkët në lindjen e Jezusit në atë martesë, edhe pse jo nga ajo martesë. Shën Toma paraqet me qartësi principin që "fëmijët nuk i përkasin martesës vetëm sepse të lindur nëpërmjet saj, por sepse në martesë pranohen dhe edukohen". Për të përfunduar që "kjo martesë (e Jozefit me Marinë) që rregullohet veçanërisht për këtë qëllim, domethënë që ai fëmijë (Jezusi) të pranohet dhe të edukohet". Akoma: "Jozefi është në të njëjtën kohë aq baba i Krishtit sa i fejuari i Marisë, jo për virtyt të bashkimit të mishit, por të lidhjes martesore".

Realiteti i atësisë së Sh. Jozefit ndaj Jezusit tregohet nga Sh. Agustini në "mëshira dhe dashuria e Jozefit". Piu IX thotë qartë që "Jozefi jo vetëm e pa Jezusin, por me të ka banuar e me dashuri atërore e ka përqafuar dhe puthur dhe për më tepër e ka ushqyer". Luani XIII pohon që Sh. Jozefi "ushtrohet detyrën e babait për Jezusin" dhe Piu XII mëson që "edhe

pse ai nuk ishte babai i tij, pati për Jezusin, për një dhuratë të veçantë qiellore, gjithë dashurinë natyrore, gjithë kujdesin e përzemërt që një zemër babai mund të njohë". Provë le të jetë fakti që Jezusi përpara njerëzve u denjua të konsiderohej bir i Jozefit dhe iu nënshtroa (Piu IX).

Atësia e veçantë e Sh. Jozefit, pra, e vërteta e të cilës, e përvizuar nga dogma e misterit të Mishërimit, bazohet megjithatë mbi lidhje juridike, morale dhe shpirtërore, përkufizohet pjesërisht me shprehje të baba ligjor, kujdestar, ushqyes, adoptiv, virgjëror dhe zëvendës i Atit qiellor.

Benedikti XVI tregon në shenjtin, emrin e të cilit mban, shembull për priftërinjtë, rregulltarë dhe laikë. Ai, që "nuk është babai biologjik i Jezusit, tregon, që me gjithë këtë, mund të ushtrohet "një atësi e plotë dhe e tërë. Të jesh baba është para se gjithash të jesh shërbëtor i jetës dhe e rritjes. Sh. Jozefi ka dhënë provë në këtë kuptim, të një përkushtimi të madh". Për të gjithë ai është shembulli i atësisë shpirtërore.

"Për Krishtin ka njohur persekutimin, mërgimin dhe varfërinë që rridhte si pasojë. Është stabi lizuar në një vend të ndryshëm nga fshati i tij. Shpërblimi i tij i vetëm që të ishte me Jezusin.

Kjo gatishmëri shpiegon fjalët e shën Palit: "Zotëria është Krishti; shërbëjini Atij" (Kol 3, 24). Bëhet fjalë të mos jesh një shërbëtor i rëndomtë, por të jesh një shërbëtor "besnik dhe i urtë". Kombinimi i dy mbiemrave jo të rastësishëm: sugjeron që zgjuarsia pa besnikëri dhe besnikëria pa urtëni janë cilësi jo të mjaftueshme, njëra pa tjetrën nuk lejon të marrësh plotësisht përgjegjësinë që Hyji të beson".

E njëjta gjë vlen për ata që kanë zgjedhur jetën e kushtuar dhe për laikët. Sh. Jozefi na mëson që mund të duhet pa zotëruar. Duke e soditur çdo burrë dhe çdo grua, me hirin e Hyjit, të shërohet nga plagët e tij afektive me kusht që të hyjë në projektin që Hyji tashmë ka filluar të realizojë në qeniet që janë afër Tij, kështu si Jozefi ka hyrë në veprën e shëlbimit nëpërmjet figurës së Marisë dhe falë asaj që Hyji kishte bërë në të.



■ SHKRUAN:
Don Albert JAKAJ

Më 10 dhjetor 2009, u shënua 30-vjetori i marrjes së shpërblimit "Nobel" për paqe, me të cilin u vlerësua figura e Nënës Tereze. Me këtë rast në Teatrin Kombëtar në Prishtinë, u zhvillua një akademi solemne për të përkujtuar këtë përvjetor të rëndësishëm, i cili u mbajt nën patronazhin e Presidentit. Viti 2010 mund të konsiderohet si vit i Nënës Tereze, kjo për shkak se është vit jubilar i saj, pasi që në këtë vit bëhen 100 vjet që nga lindja e saj. Për të nderuar figurën e Nënës Tereze, institucionet kosovare janë mbledhur së bashku dhe kanë premtuar se gjatë vitit të ardhshëm do të ketë një serë aktivitete të kulturës dhe shkencës, që do t'i kushtohen nobelistes shqiptare me famë botërore.

Ministria e Kulturës tashmë ka themeluar Këshillin Organizativ që do të merret me organizimin e këtyre aktiviteteve, i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme. Anëtarë të këtij këshilli janë: Valton Beqiri, ministër, Xhavit Beqiri nga Presidencia e Republikës së Kosovës, Akademik Ali Podrimja nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Dr. Don Lush Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës dhe Dr. Jusuf Bajraktari nga Instituti i Historisë.

Në këtë solemnitet, ku

merrnin pjesë personalitete të vendit dhe të huaj, Presidenti Sejdiu vitin e 2010 e shpalli "Vit të Nënës Tereze", pikërisht në 100-vjetorin e lindjes së saj së saj. Nëna Tereze është nderuar me Çmimin Nobel për Paqe, në vitin 1979.

Presidenti Sejdiu në fillim të fjalës së tij tha se tridhjetë vjet më parë, Nëna Tereze teksoi nga manifestimi solemni, pasi iu dorëzua Çmimi Nobel, në një foto portret të sajën shkroi këto fjalë: "Une gjithmonë e kam në zemër popullin tim Shqiptar. Shumë luti Zotin që pagja e Tij të vij në zemrat tona, në gjitha familjet tona, në gjithë botën. Lutni shumë për fukarat e mij dhe për mua dhe motrat e mij. Une lutem për juve". Këto fjalë, të shkruara me thjeshtësi e sinjeritet, vazhdoi Presidenti Sejdiu, tregojnë shpirtin e rrallë të Nënës Tereze.

Fjala e parë, tha ai, dëshmon përkushtimin dhe dashurinë e saj për kombin të cilit i përkiste, duke e përfunduar këtë lidhje të pashkëputshme të saj me fatin e rëndë të kombit shqiptar në shekullin njëzet. Ndërkaq, duke folur për figurën e humanistes së madhe, Presidenti Sejdiu tha se Nëna Tereze ishte shqiptare e lindur në Shkup, me prindër nga Kosova, të cilët e kishin edukuar në frymën e vërtetë të shpirtit shqiptar, në frymën e dhembshurisë, të humanizmit dhe të dashurisë për njeriun. "Ndaj, lutja e saj një shkallëzim ngjites dhe

Akademi solemne k 30-vjetorit të lau

zgjerohet në tërë botën, bëhet universale, ashtu siç ishte zemra e saj", tha ai.

Presidenti Sejdiu vlerësoi se Nënë Tereza si "bijë e urtë e popullit shqiptar, është personalitet i rrallë edhe i Kishës Katolike Shqiptare", e cila, siç tha, e vazhdoi në mënyrë shembullore udhën e madhe të Papa Klementit, Pjetër Budit, Atë Shtjefën Gjeçovit dhe shumë e shumë misionarëve të tjerë, që dhanë aq shumë për fe e për atdhe. Por mbi të gjitha ai tha se "Nënë Tereza, padyshim, është bijë dhe nënë e gjithë njerëzimit". "Ajo është shqiptare, po, gjithashtu, është edhe indiane, italiane, amerikane, angleze. Të gjithë duan ta identifikojë si të tyre, të gjithë duan të shëmbëllojnë me të. Dhe kanë të drejtë, sepse ajo nuk ishte vetëm jona, vetëm e ne shqiptarëve, por ishte e botës mbarë, e gjithë njerëzimit", tha Sejdiu.

Në fjalën e tij Presidenti Sejdiu gjithashtu tha se "Nëna Tereze është mishërim i të gjitha virtyeve më të mira të njeriut shqiptar, por edhe të njeriut të botës", por njëherësh "ajo është shembull i papërsëritshëm i filijimit të përditshëm për njerëzit e lënë, është shembull i besimit në Zotin dhe në Njeriun". Presidenti Sejdiu rikujtoi se përveç Çmimit Nobel, Nëna Tereze është nderuar edhe me shumë çmime të tjera të mëdha që jep sot bota, si: Çmimi "Pamada Shir" (1962), mirënjohja më e madhe kombëtare indiane, Çmimi "Papa Gjoni XXIII për Paqe" (1971), mirënjohja e parë e madhe nga Kisha Katolike, e cila iu dha nga vetë Papa Pali VI, Çmimi "Xhon Kenedi" (1971), Çmimi "Nehru", Çmimi "Nëna e të gjitha nënave" (1973), Çmimi "Medalja e Lirisë" (1985), i cili iu dha nga vetë Presidenti amerikan Ronald Regan. Më 28 tetor 1996, Presidenti historik i Kosovës, Ibrahim Rugova e shpalli Nënë Terezen "Qytetare Nderi e Republikës së Kosovës", ndërsa në të njëjtin vit, Presidenti i atëhershëm i Shqipërisë, Sali Berisha e nderoi Nënë Tereze me "Urdhrin e Artë të Popullit Shqiptar".

Presidenti Sejdiu tha se duke i pasur parasysh të gjitha virtyet dhe cilësitë e rralla njerëzore e kombëtare të Nënës Tereze, duke pasur parasysh veprën e saj të madhe jetësore, ka marrë vendim që të shpallë vitin 2010, vitin që shënon njëqindvjetorin e lindjes së Gonxhe Bojaxhiut,



"Vit të Nënës Tereze". Me këtë, ai njëkohësisht, deklaroi se jep Patronazhin e tij për të gjitha veprimtaritë që Ministria e Kulturës dhe institucionet e tjera shkencore, arsimore e kulturore do të organizojnë për ta nderuar e për ta lartësuar emrin e ndritur të Nënës Tereze. Nëna Tereze botërisht u shpall "Personalitet i Shekullit XX". Shpallja e vitit 2010 "Vit i Nënës Tereze" është një mirënjohje jona e vogël për këtë bijë të madhe të botës shqiptare dhe të gjithë njerëzimit, tha në fund Presidenti Sejdiu.

Më pas fjalën e mori Ipeshkvi i Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, i cili u shpreh se ndjehet i privilegjuar që nga foltoja e teatrit, të shpalojë një pjesë shumë të vogël nga jeta e veprimtarës shqiptare. "30 vjet më parë, ne të gjithë shqiptarët, ishim nën prangat e diktaturës dhe jetonim në terrin e ideologjisë që na impononte koha. Pas rënies së diktaturave, në Shqipëri dhe Kosovë, janë përpjekje të mëdha për të nderuar dhe promovuar figurën Nënë Tereze, siç është edhe akademia e sotme kremtore. Ky është një moment shumë i mirë për të promovuar edhe nismat e marra nga Këshilli Organizativ për vitin jubilar-100 vjetorin e lindjes së Gonxhes së Bojaxhiut, Nënës tonë Tereze" nënvizoi ai.

Don Lush Gjergji, një prej studiuesve më të shquar të biografisë së Nënës Tereze në Kosovë, në fjalën e tij të rastit

tha "Më 10 dhjetor të vitit 1979 Nëna Tereze e ka marrë çmimin Nobel për paqe dhe me atë rast ajo, para 1200 gazetarëve e tregoi edhe njëherë identitetin dhe personalitetin e saj, duke cituar fjalët e saj "Unë gjithmonë e kam në zemër popullin tim shqiptar" u shpreh Don Lush Gjergji. Ai shtoi se 30-vjetori i marrjes së çmimit Nobel u paraprin ngjarjeve të tjera madhore për të nderuar Nënë Terezen.

Don Lush Gjergji e vlerësoi Nënë Terezen si një pasaportë unike që e kemi ne. Ajo, sipas tij, është një letërnjoftim yni, është një çelës universal që na e hap rrugën që gjurmëve të saj të paraqitemi si njerëz të paqes. "Paqja lind në mendje, kultivohet në zemër dhe shprehet nëpërmjet dashurisë", përfundoi Don Lush Gjergji.

Nga ana tjetër personalitetet botërore e kanë vlerësuar dhe vazhdojnë të vlerësojnë lart emrin dhe punën e saj. Ndërsa Papa Gjoni Pali II, nga ballkoni i Arqipeshkvisë së Shkodrës, në mes të tjerash tha "nuk mund të harrojmë të përsëritshëm një person shumë të thjeshtë, që ndodhet midis nesh, Nënë Terezen e Kalkutës. Të gjithë e dinë nga është, cila është vendlindja e saj... Nënë Tereza edhe gjatë periudhës, që Shqipëria ishte e izoluar krejt, kjo murgëshë e përvuajtur, kjo shërbëtoare e vlefshme e të varfërve e solli emrin tuaj në të gjithë botën. Shqipëria është gjithmonë

ushtuar Nënës Tereze me rastin e rimimit të saj me Çmimin Nobel

krenare me Nënë Terezën. Sot në emër të Kishës, të falënderoj ty, Shqipëri e dashur, për këtë bijë të tokës tënde e të popullit tënd”.

Të gjitha ngjarjet me karakter shkencor – kulturor do të mbahen nën patronatin e Presidentit të Republikës së Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, ndërkaq organizimi i tyre do të bëhet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga institucionet e larta shkencore dhe kulturore, të tilla si: Ipeshkvia e Kosovës, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Instituti i Historisë, Biblioteka Kombëtare dhe Universiteti e Kosovës, Filharmonia – Opera e Kosovës, Galeria e Arteve e Kosovës, Teatri Kombëtar i Kosovës, Instituti Albanologjik, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare si dhe nga shtëpi të ndryshme botuese.

Kalendari i ngjarjeve dhe veprimtarive kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës – Gonxhe Bojaxhiut do të publikohet në fillim të janarit të vitit 2010.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zyrtarë të lartë të shtetit dhe emra të njohur nga veprimtari të ndryshme të vendit, si Presidenti i Kosovës, Dr. Fatmir Sejdiu, ministri i Kulturës z. Valton Beqiri, ambasadori i Ambasadës amerikane në Prishtinë z. Cristofer Dell, ambasadori i Shqipërisë z. Islam Lauka, Ipeshkvi i Kosovës Mons. Dodë Gjergji, Dr. Don Lush Gjergji, meshtarë e murgësia nga mbarë Diqoza e Kosovës, si dhe një numër i madh besimtarësh...

Kanë thënë për Nënë Terezën:

“Sot në emër të kishës, të falënderoj ty, Shqipëri e dashur, për këtë bijë të tokës tënde e të popullit tënd.” (Papa Gjon Pali II)

“Nënë Tereza e mahniti botën me luftën e saj unike. Ajo nuk kishte asnjë armë, asnjë forcë, asnjë metodë detyrimi ndaj të tjerëve.” (Dr. Fatmir Sejdiu, President i Kosovës)

“Ky është një moment shumë i mirë për të promovuar edhe nismat e marra nga Këshilli Organizativ për vitin jubilar-100 vjetorin e lindjes së Gonxhes së Bojaxhiut” (Mons. Dodë Gjergji, Ipeshkvi i Kosovës)

“S’mund të jetë popull i vogël ai që e ka dhënë një Nënë kaq të madhe, Nënë Terezën.” (Kardinali Paskal, kryetar i Konferencës Ipeshkvnore Hungareze)

Fjala e Presidentit Sejdiu, në Akademinë solemne me rastin e 30-vjetorit të laurimit të Nënë Terezës me çmimin Nobel

Të nderuar drejtues të institucioneve të vendit,

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Të nderuar ambasadorë të akredituar në Prishtinë,

Të nderuar përfaqësuesit të institucioneve arsimore, shkencore e kulturore,

Të nderuar përfaqësues të klerit,

Të nderuar përfaqësues të medieve,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja e zotërinj,

Tridhjetë vjet më parë, Nëna Tereza tekso po dilte nga manifestimi solemni i pranimit të çmimit “Nobel”, duke ia nënshkruar Dom Lush Gjergji një foto-portret të saj, i shkroi këto fjalë: “Une gjithmonë e kam në zemër popullin tem Shqiptar. Shum luti Zotin që paqja e Tij të vij në zemrat tona, në gjitha familjet tona, në gjithë botën. Lutnu shumë për fukarat e mij – dhe për mua dhe motrat e mija. Une lutem për juve”.

Këto fjalë, të shkruara me thjeshtësi e sinqeritet, tregojnë shpirtin e rrallë të Nënës Tereze. Fjalja e parë – Une gjithmonë e kam në zemër popullin tem Shqiptar – dëshmon përkushtimin dhe dashurinë e saj për kombin të cilit i përkiste. Ndajfolja gjithmonë vetëm sa e përforcon këtë lidhje të pashkëputshme të saj me fatin e rëndë të kombit shqiptar në shekullin njëzet. Prandaj, ajo lut shumë Zotin që “Paqja e Tij të vij në zemrat tona, në të gjitha familjet tona, në gjithë botën”.

E vetëdijshme për gjendjen e vështirë të mijëra familjeve shqiptare në atë kohë, Nëna Tereza lutet që Paqja e Hyjit të zbrisë në të gjitha familjet tona, në të gjitha familjet tona shqiptare, të cilave asokohe iu mohojë edhe e drejta e lutjes. Por, Nëna Tereza nuk e ngushton rethin e njerëzve për të cilët lutet. Ajo ishte shqiptare e lindur në Shkup, me prindër nga Kosova, të cilët e kishin edukuar në frymën e vërtetë të shpirtit shqiptar, në frymën e dhembshurisë, të humanizmit dhe të dashurisë për njeriun. Ndaj, lutja e saj një shkallëzim ngjitet dhe zgjerohet në tërë botën, bëhet universale, ashtu siç ishte zemra e saj.

Nëna Tereza, misionare e paqes dhe e dashurisë, lut Zotin që t’u japë paqen e Tij të gjitha familjeve të botës. Për t’u kthyer në fjalitë vijuese, në thelbin e përkushtimit të saj jetësor e shpirtëror, në përkushtimin, dhembjen dhe lutjen për të varfrit, për fukarat e saj.

Nëna Tereza e mahniti botën me luftën e saj unike. Ajo nuk

kishte asnjë armë, asnjë forcë, asnjë metodë detyrimi ndaj të tjerëve. Ajo kishte vetëm lutjen dhe sakrificën e pandalur për të tjerët, për të braktisurit, për të sëmurët, për të pasipresët. Ajo ishte vetë shpresa e tyre në këtë jetë, ishte dielli që ua sillte agun e ditës së re, ishte hëna që ua hiqte terrin që kishte pllakosur jetët skamnore.

Nëna Tereza, bijë e urtë e popullit shqiptar, është personalitet i rrallë edhe i Kishës Katolike Shqiptare. Ajo e vazhdoi në mënyrë shembullore udhën e madhe të Papa Klementit, Pjetër Budit, Atë Shijefit Gjocovit dhe shumë e shumë misionarëve të tjerë, që dhënë aq shumë për fe e për atdhe, duke u nisur nga besimi i thellë se vetëm duke u shërbyer të tjerëve mund ta fitosh paqen dhe parajsën e Zotit dhe njëkohësisht të jesh i dobishëm për veten dhe për popullin tënd.

Nëna Tereza, pa dyshim, është bijë dhe nënë e gjithë njerëzimit. Ajo është shqiptare, po, gjithashtu, është edhe indiane, italiane, amerikane, angleze... Të gjithë duan ta identifikojë si të tyre, të gjithë duan të shembëllojnë me të. Dhe kanë të drejtë, sepse ajo nuk ishte vetëm jona, vetëm e ne shqiptarëve, por ishte e botës mbarë, e gjithë njerëzimit.

Që në moshë të njomë ajo ndoqi udhën e saj jetësore dhe mori udhën e largët drejt Kalkutës. Me vetëdije të plotë dhe me qëllim e lartë për t’ua zgjatur dorën e ndihmës atyre që kishin mbetur të harruar në lymin e vrazhdësisë së jetës dhe mizorisë së mjerimit social, ajo braktisi familjen e dashur, la vendlindjen dhe iu përkushtua me tërë shpirtin shërbimit për të varfrit. Ndaj, mund të themi lirisht se Nëna Tereza është mishërim i të gjitha virtyeve më të mira të njeriut shqiptar, por edhe të njeriut të botës. Ajo është shembull i papërsëritshëm i flajitit të përditshëm për njerëzit e lënë, është shembull i besimit në Zotin dhe në Njeriun.

Të nderuar pjesëmarrës, Rrallëkush në botën moderne mund të krahasohet me Nënë Terezë sa i përket namit dhe dashurisë që ajo gëzonte anekënd globit. Mirënjohjet dhe epitetet që fitoi ajo për të gjallë nuk mund të numëron.

Vërtet, Nëna Tereza e fitoi çmimin Nobel për Paqe më 1979, por më parë ajo kishte fituar një çmim shumë më të madh, kishte fituar dashurinë dhe qindra-miliona njerëzve nga e gjithë botës, kishte fituar nderimin e përhershëm të njerëzve pa dallim kombi e besimi. Prandaj, themi se ajo është njësoj e të gjithëve, e krishterëve dhe e



myslimanëve, e të pasurve dhe e të varfërve. Ajo është shembulli më i shkëlqyeshëm i pastërtisë njerëzore dhe i dashurisë për njeriun pavarësisht statusit të tij shoqëror.

Nëna Tereza e nderua me çmimet më të mëdha që jep sot bota. Përveç Nobelit, ajo mori edhe shumë mirënjohje të tjera shumë prestigjioze si: Çmimi “Pamada Shir” (1962), mirënjohja më e madhe kombëtare indiane, Çmimi “Papa Gjon XXIII për Paqe” (1971), mirënjohja e parë e madhe nga Kisha Katolike, e cila u dha nga vetë Papa Pali VI, Çmimi “Gjon Kenedi” (1971), Çmimi “Nehru”, Çmimi “Nëna e të gjitha nënave” (1973), Çmimi “Medalja e Lirisë” (1985), i cili u dha nga vetë Presidenti amerikan Ronald Regan.

Më 28 tetor 1996, Presidenti historik i Kosovës, dr. Ibrahim Rugova e shpalli Nënë Terezë “Qytetare e Nderit e Republikës së Kosovës”, ndërsa në të njëjtin vit, Presidenti i atëhershëm i Shqipërisë, dr. Sali Berisha e nderoi Nënë Terezë me “Urdhrin e Artë të Popullit Shqiptar”.

“Nëna Tereza ka tejkaluar personalisht humnerën që ekziston mes të varfërve dhe të pasurve. Vizioni i saj i dinjitetit njerëzor ka ngritur një urë”, arsyetonte tri dekada më parë dr. Gjon Sanes vendimin e Komitetit Nobel për Paqe, derisa po ia dorëzonte mirënjohjen Nënës Terezë në Universitetin e Oslos.

Vlerësime të këtylla, të cilat shprehin konsideratat më të larta për figurën e Nënës Terezë kanë dhënë personalitet më të shquara të kohës sonë, si Papa Gjon Pali II, Presidenti amerikan Bill Clinton, Kryeministri britanik Toni Bler, Presidenti Italian Sandro Pertini, Presidenti frances Zhak Shirak etj.

Pjesëmarrës të nderuar të kësaj akademie solemne,

Duke i pasur parasysh të gjitha vertytet dhe cilësitë e rralla njerëzore e kombëtare të Nënës Terezë, duke pasur parasysh veprën e saj të madhe jetësore, si dhe duke u mbështetur

në përgjegjësitë dhe kompetencat që kam si President i vendit, pas konsultave edhe me Ministrinë e Kulturës, me përfaqësuesit e klerit dhe me përfaqësuesit të shquar të komunitetit tonë kulturor, kam marrë vendim që të shpall vitin 2010, vitin që shënon njëqindvjetorin e lindjes së Gonxhe Bojaxhiut, “Vit të Nënës Tereze”. Me këtë, njëkohësisht, deklaroj se jap Patronazhin tim për të gjitha veprimtaritë që Ministria e Kulturës dhe institucionet e tjera shkencore, arsimore e kulturore do të organizojnë për ta nderuar e për ta lartësuar emrin e ndritur të Nënës Tereze.

Sivjet, simbolika e ditës së sotme, 10 Dhjetorit – Ditës së të Drejtave të Njeriut, për ne bashkëkombësit e Nënës Tereze, ka domethënie të shumëfishtë, sepse përkon pikërisht me ditën kur bija jonë, Nëna Tereza, kjo luftëtare e madhe për të drejtat e njeriut dhe për dinjitetin njerëzor përgjithësisht, u nderua me mirënjohjen më të madhe për paqe, me çmimin “Nobel”.

Uroj që ky vit të përshkohet me veprimtari të mirëfillta shkencore e kulturore, në mënyrë që sadoqap, si institucione të Republikës së pavarur të Kosovës, t’i dalim borbxit kësaj bije të madhe të popullit shqiptar, kësaj nëne madhështore të gjithë njerëzimit.

Bota na njeh më mirë nëpërmjet Nënës Tereze. Ne na mbetet të mësojmë prej saj si ta duam më shumë botën, botën e sotme të diversiteteve dhe të kundërtënieve të përhershme.

Nëna Tereza botërisht u shpall “Personalitet i Shekullit XX”. Shpallja e vitit 2010 “Vit i Nënës Tereze” është një mirënjohje jona e vogël për këtë bijë të madhe të botës shqiptare dhe të gjithë njerëzimit.

Ju faleminderit!



Intervistë me veprimtarin e shquar, z. Marjan Cubi

Në Amerikë mbahet gjallë jeta shpirtërore, kulturore e kombëtare e shqiptarëve

Këto ditë, për revistën "Drita", bëmë këtë intervistë me veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare dhe fetare, z. Marjan Cubi, i cili jeton dhe vepron në Amerikë, përkatësisht në Nju Jork.

"Vatra", për shumë vjet ka luajtur rol të rëndësishëm në veprimtarinë kombëtare dhe kulturore

"Drita": Zotëri Cubi, edhe pse jeni emër mjaft i njohur në opinionin tonë, e konsiderojmë të arsyeshme që për lexuesit tanë të na jepni një pasqyrë të shkurtër për biografinë tuaj.

Marjan Cubi: I lindur jam në fshatin Drenoc të Klinës, më 1948 dhe i pagëzuar në Kishën e Glogjanit. Shkollën fillore (tetëvjeçare) e mbarova në vendlindje, shkollën Industriale dhe Shkollën e Lartë-Teknologjike për Jometale në qytetin e Arangjellovit. Në vitin 1970 kam shkuar në shërbimi i ushtarak, në vitin 1972-1973, kam punuar në Bengazi-Libi; më 1974 kam kërkuar azil politik në Vjenë-Austri. Më 13 nëntor 1974 kam arritë në SHBA New York. Jam martuar dhe kurorëzuar më 1976 me znj. Dila Gjuraraj në Kishën-Katolike Shqiptare të New Yorkut. Kemi djalin Ilirin, vajzat Afroditen dhe Terezen. Iliri i ka dy djem, Jozefin dhe Noun. Terezja ka vajzën Izabelen. Kam qenë aktiv gjatë gjithë jetës time, por jam angazhuar deri në maksimum në ShBA dhe kam përkrahur çdo gjë që lidhet me binomin: "fe dhe atme".

"Drita": Ka shumë vite që jeni veprimtar i shquar në Amerikë. Në cilat veprimtari shquhet aktiviteti dhe angazhimi juaj, qoftë kombëtar, po ashtu edhe fetar?

Marjan Cubi: Posa kam arritur në ShBA, më 1974 jam regjistruar dhe aktivizuar në Kishën Shqiptare Katolike të New Yorkut. Më vonë nga këshilli i Kishës jam zgjedhur edhe Kryetar i Këtij këshilli për shumë vite. Më 1979 jam regjistruar dhe anëtarësuar në shoqatën "Vatra". Edhe sot jam anëtar i Kryesisë së "Vatrës". Më 1989, po sa

ishite themeluar LDK (Lidhja Demokratike Kosovës), jam një nga themeluesit i Degës së LDK për NY-NJ-CT. Gjashtë vjet isha nënkryetar i kësaj dege dhe nga viti 1998 deri më 2002 isha edhe kryetar i degës.


"Drita": Pra, shoqëria "Vatra", e cila për shumë vjet ka luajtur rol të rëndësishëm në veprimtarinë kombëtare dhe atë të kulturës, çfarë keni mundësi të na prezantoni rreth rrugës së veprimtarisë së kësaj shoqërie, e cila në Amerikë ka një traditë të begatë dhe e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në shumë fusha të jetës?

Marjan Cubi: Shoqata VATRA është themeluar më 1912 nga Fan Noli dhe Faik Konica me bashkëmendimtarët e kohës. Ka luajtur një rol të madh në zhvillimet e të gjitha fazave të shqiptarëve në përgjithësi. Ka pasur shumë rëndësi në përkrahjen e fitores së pavarësisë së Shqipërisë, ashtu si ka pasur rëndësi edhe ish- presidenti Wilson për pavarësinë më 1912. VATRA ka pasur rëndësi edhe për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ashtu siç e kanë pasur këtë rëndësi presidentët e ShBA Klinton dhe Bush. Veçantia e kësaj shoqate ka qenë orientimi-demokratik i djathtë dhe proamerikan. Prandaj, ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimet demokratike të shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi e kudo që jetojnë ata.

Mërgata shqiptare në Amerikë ka kryer obligimin e vet karshi çështjes së Kosovës

"Drita": Zotëri Marjan Cubi, mërgata shqiptare në Amerikë ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në sensibilizimin e çështjes së Kosovës dhe shqiptarizmes në përgjithësi. Çfarë mund

Kisha-Katolike-Shqiptare "Zoja e Shkodrës" në New York



"Kisha-Katolike-Shqiptare "Zoja e Shkodrës" ka qenë dhe është një qendër shpirtërore dhe kulturore, por edhe kombëtare, sepse Kisha ka organizuar shumë shënime të rëndësishme, si 300- vjetorin e vdekjes së Imzot Pjetër Bogdanit, 50- vjetorin e vdekjes së Atë Gjergj Fishtës, 600- vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeu, 100- vjetorin e Kongresit të Manastirit dhe për çdo vit shënohet përvjetori i "Nënës Tereze" e tjera."

të na flisni rreth kësaj dhe angazhimeve konkrete të personaliteteve të veçanta?

Marjan Cubi: Mërgata shqiptare në Amerikë ka pasur efektin më të madh në mbarë diasporën, sepse është shteti i ShBA-ve ai që është më demokratik në botë dhe iu mundëson të gjitha etniteteve të shumta dhe të ndryshme që të tregojnë dhe shprehin dhembjet e tyre për vendet e tyre që vuajnë nga represioni dhe diskriminimi. Prandaj, mërgata shqiptare në Amerikë, e ka kryer detyrën e vet duke i dhënë materiale të shumta për çdo veprimtari që ka bërë sllavo-komunizmi ndaj shqiptarëve të pafajshëm qoftë ai millosheviqian, apo edhe ai enveristo-stalinian. Kemi demonstruar pranë Shtëpisë së Bardhë në Washington, pranë OKB në New York, në Dejtton dhe vende tjera. Kemi dërguar letra dhe informacione të ndryshme në të gjitha institucionet e ShBA-ve. Kemi kontaktuar që nga Presidenti i ShBA-ve, senatorët, kongresistët dhe të gjithë ata që kanë ndikim për çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Puna që bëjnë shqiptarët dhe organizimet të ndryshme, kanë bërë që shqiptarët në Amerikë të jenë një shembull i mirë. Shqiptarët, të organizuar rreth kishave, xhamive, Balli Kombëtar, OL. Legaliteti, Blloku Kombëtar, LDK, Sh.A. Dibran, A.A.C.L., A.A.N.C., e tjera.

"Drita": Jeni i angazhuar edhe në publicistikë, cilat janë ecjet tua në këtë lëmi?

Marjan Cubi: Megjithatë jam shumë i ngarkuar me obligimet familjare, aktivitete dhe punë të shumta, kam shkruar shumë artikuj në gazetën Dielli, në gazetën Illyria dhe tjera. E kam botuar një libër të titulluar "Në emër të lirisë dhe pavarësisë", më 2004.

"Drita": Çfarë temash dhe motiveve keni ngërthyer në këtë libër?

Marjan Cubi: Në librin tim kam përshkruar një kronologji për një periudhë të caktuar të ditëve më të vështira të historisë shqiptare, por edhe të lavdishme.

Në këtë libër janë të shënuara edhe shumë veprimtari dhe aktivitete, mbledhje, demonstrata, takime me njerëz të mëdhenj dhe të rëndësishëm për shqiptarët, si Papa Gjon Pali II, Presidenti Amerikan, senatorë, kongresistë, Dr. Ibrahim Rugova, Ispeshkvi, delegacione të shumta, pastaj udhëtime të shumta nga New York-Kalkuta, N.Y.-Romë, N.Y.-Tiranë, N.Y.-Prishtinë dhe të tjera.

"Drita": Përveç angazhimit tuaj në këtë shoqëri kulturore dhe atdhetare, veprimtaria juaj nuk ka pashuar as në kuadër të veprimtarive që ka zhvilluar Kisha Shqiptare Katolike në Nju Jork,

çfarë mund të thoni lidhur me aktivitetin tuaj në kuadër të këtij institucioni?

Marjan Cubi: Kisha-Katolike-Shqiptare "Zoja e Shkodrës" në New York është një institucion që mbledh rreth vetes më së 3 mijë familje shqiptare të regjistruara dhe 2 mijë të tjerë që nuk janë të regjistruara, por i marrin shërbimet dhe sakramentet.

Mendoj, se kjo është një kishë më e madhe dhe më e pasur në botën shqiptare. Nën udhëheqjen e famullitarit shumë të dedikuar, Dom Pjetër Popaj, çdo të diel mbledhen me mijëra shqiptarë për ta dëgjuar fjalën e Zotit.

Në këtë tempull përshpirtëror dhe kulturor, po ashtu organizohen shumë aktivitete kulturore-artistike. Unë kam qenë mjaft aktiv edhe në kohën e ndërtimit të kësaj kishë, por edhe në organizimin e shumë veprimtarive kulturore e artistike që janë organizuar në kuadër të kësaj kishë. Kam qenë edhe kryetar i shoqatës kulturo-artistike "Rozafati", që ka tubuar dhe tubon shumë të rinj dhe të reja për ta prezantuar këngë dhe valle të ndryshme, recitime dhe veprimtari të tjera kulturore.

Kur kjo shoqatë ka përgatitur dhe organizuar shfaqje kulturore në SHBA, ende nuk kishte organizime të tjera të tilla, sepse efekti i ish-komunizmit në vendinjet tona shqiptare kishte ndikim dhe arrinte të gjendte në çdo mjedis.

Kisha Shqiptare Katolike ka luajtur dhe luan rol shumë të rëndësishëm në jetën e shqiptarëve në Amerikë

"Drita": Si qëndron organizimi i Kishës Katolike Shqiptare në Amerikë, përkatësisht në Nju Jork?

Marjan Cubi: Kisha Katolike Shqiptare "Zoja e Shkodrës" është si çdo kishë tjetër në New York dhe i takon Diocezës së New Yorkut.

Këtu, në këtë kishë tubohen shumë shqiptarë për të ushtruar besimin e tyre në gjuhën e ëmbël shqipe.

Famullitari shumë i respektuar, Dom Pjetër Popaj, e udhëheq këtë famulli me një Këshill të Kishës dhe me besimtarë dhe aktivistë të mirë. Organizon shumë veprimtari kulturore dhe shënime të ndryshme të rëndësishme.

Me rëndësi është se këtu flitet shqip, këndohet shqip, vallëzohet shqip dhe kultivohet kultura shqiptare duke rezistuar asimilimin në SHBA.

"Drita": Kisha katolike "Zoja e Shkodrës" në Nju Jork, përkatësisht në Hartsdale, gjatë tërë kohës së funksionimit të saj ka luajtur rol shumë të rëndësishëm; ka qenë një vend-



takim shpirtëror e kulturor për shqiptarët në Amerikë.

Marjan Cubi: Kisha-Katolike-Shqiptare "Zoja e Shkodrës" ka qenë dhe është një qendër shpirtërore dhe kulturore, por edhe kombëtare, sepse Kisha ka organizuar shumë shënime të rëndësishme, si 300- vjetorin e vdekjes se Imzot Pjetër Bogdanit, 50- vjetorin e vdekjes së Atë Gjergj Fishtës, 600- vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, 100- vjetorin e Kongresit të Manastirit dhe për çdo vit shënohet përvjetori i "Nënës Tereze" e tjera. Po ashtu, në kuadër të shumë veprimtarive të organizuara, vazhdimisht kemi pasur të ftuar studiues dhe shkencëtarë të njohur, si prof. Martin Camaj, prof. Arshi Pipa, dr. Ibrahim Rugova, Patër Daniel Gjecaj dhe shumë e shumë të tjerë.

Për Katedralen "Nëna Tereze" nga komuniteti shqiptarë në Amerikë janë grumbulluar rreth 1 milion euro

"Drita": Në kuadër të kësaj Kishë është themeluar edhe Fondi për grumbullimin e mjeteve për ndërtimin e Katedrales "Nëna Tereza" në Prishtinë. Ju njëkohësisht jeni edhe kryetar i këtij Fondi, çfarë keni mundësi të na pasqyroni punën dhe të arriturat e këtij fondi?

Marjan Cubi: Në fillim të vitit 2008 kemi themeluar një Këshill për fondacion të katedrales "Nëna Tereze" në Prishtinë. Jemi tubuar në sallën e Kishës, e cila njëherësh mban emrin e Nënës Tereze. Ky këshill është shumë i veçantë, sepse përfshin anëtarë nga tri besimet që jetojnë në New York me rrethë dhe këta shqiptaro-amerikanë janë po ata të cilët kanë kontribuar gjatë dekadave për çështjen kombëtare dhe atë

për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Por, edhe për ndërtimin e kishave në të gjitha trojet shqiptare, Shqipëri, Kosovë, Malësi. Numri i anëtarëve është më se 50 veta dhe janë të ardhur nga Shqipëria, Kosova, Malësia (Tuzi, Hoti, Gruda, Trieshi, Koja e Kucit), Ulqini, Gucia dhe nga të gjitha trojet shqiptare.

Jam shumë i lumtur që pata fatin të zgjidhem kryetar i këtij Fondacioni.

Kemi organizuar dy mbledhje madhështore, një më 25 maj 2008 dhe një tjetër, maj 2009.

Kemi pasur edhe mysafirë nga Kosova, Imzot Dod Gjergjin, Dom Fran Kola, Dom Lush Gjergjin dhe Dom Shan Zefin. Mendoj se kemi pasur shumë sukses në mbledhjet dhe në mbledhjet e fushatës. Janë dërguar deri tani më se 900 mijë dollarë dhe janë të premtuara më se 100 mijë dollarë dhe kështu e kalojnë shifrën prej 1 milion dollarë, që do të thotë nga një komunitet shqiptaro-amerikan të New Yorkut me rrethë, duhet të quhet sukses, sepse kjo ishte dashur të nxit edhe shqiptarët e Detroitit, të Gjermanisë, Zvicrës, Kroacisë dhe pse jo edhe të Kosovës dhe Shqipërisë.

Unë, si kryetar dhe i gjithë këshilli e falënderojmë Dom Pjetrin që na ndihmoi dhe na përkrahi që të arrimë sukses dhe ta ndërtojmë Katedralen e "Nënës Tereze".

Ne si këshill e kemi mandatin deri në shtator të vitit 2010 të vazhdojmë me punën tonë derisa të bekohet Katedralja me rastin e 100- vjetorit të lindjes së Nënës Tereze.

"Drita": Sa jeni të kënaqur me grumbullimin e këtyre mjeteve në Amerikë dedikuar ndërtimit të Katedrales në Prishtinë?

Marjan Cubi: Jam shumë i kënaqur për organizimin dhe për

grumbullimin e mjeteve dhe që do ta kemi një katedrale shumë të bukur me emrin shumë të bukur "Nëna Tereze".

Kjo Katedrale do të ketë rëndësi fetare, kombëtare, kulturore dhe historike, është dëshmi e autoktonisë së popullit shqiptaro-ilir-dardan.

"Drita": Në Nju Jork botohet edhe revista fetare, kulturore dhe informative "Jeta katolike", çfarë keni mundësi të na thoni rreth konceptit të kësaj reviste dhe rolit të saj në fushën informative e kulturore?

Marjan Cubi: Pranë kishës sonë "Zoja e Shkodrës" botohet edhe revista për çdo tre muaj, e titulluar "Jeta Katolike". Kjo revistë është mjaft informative, mjaft kulturore dhe mjaft e "hijshme", e ilustruar dhe me ngjyra të ndryshme.

"Drita": Cili është mesazhi juaj për lexuesit të revistës sonë "Drita"?

Marjan Cubi: Së pari e falënderoj redaksinë e revistës "Drita" me bashkëpunëtorët e tyre që më dhanë hapësirë, që nëpërmjet kësaj interviste t'i prezantoj këto opinione të mia. Gjithë lexuesve të revistës "Drita" u uroj sukses dhe dëshiroj që këtë revistë shumë të dashur dhe të nevojshme për lexuesit, shume informative dhe të pasur me materiale të rëndësishme ta ndihmojnë, në mënyrë që ta vazhdojë katolikë, t'ua uroj, Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2010, duke ju dëshiruar mbarësi në veprimtari të tyre dhe në jetë.

Po ashtu, shfrytëzoj rastin që gjithë lexuesve dhe besimtarëve katolikë, t'ua uroj, Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri 2010, duke ju dëshiruar mbarësi në veprimtari të tyre dhe në jetë.

Intervistuan:
Mikel Gojani, Vilson Culaj

Kompozitori i parë i Meshës shqiptare në Kosovë të ritit katolik

Rauf Dhomi, krijues i devotshëm i një bote të magjishme muzikore

"Kompozitorin Rauf Dhomi e konsideroj si një nga figurat më të rëndësishme të muzikës serioze shqiptare", Zhani Ciko, drejtor i teatrit të operës dhe baletit të Tiranës

■ SHKRUAN:
AKIL KOCI

Shtysën për të shkruar për Muzikën sakrale si kontinuitet i serisë së eseve të mi me titull Musica Sakra ose Muzika shenjte, ma kanë dhënë krijimet e reja në këtë gjini, si komunikim i ri në krijimtarinë e disa krijuesve tanë e që paraqet një objekt hulumtimi dhe studimi për këtë krijimtari në tërësinë e saj. Mund të them lirisht, se ky hulumtim paraqet një studim të thelluar në tërë kompleksitetin e vet. Më ka dhënë mundësi jo vetëm të njihem me këtë lloj të krijimtarisë, por përmes Revistës Drita si botim i Ipeshkvisë së Prizrenit t'i njoh lexuesit e saj me veprat sakrale të kompozitorëve të shquar shqiptar, si dhe të hulumtoj më thellë dhe të gjej metaforat e të shprehurit artistik të kompozitorëve tanë. Asnjëherë nuk janë përfshirë krijuesit e këtij lëmi në vazhdim, si në revistën "Drita", pra veprat e krijuara nuk janë vlerësuar në aspektin muzikor, artistik, shkencor dhe estetik, por as në të shumtën e rasteve ato nuk janë prezantuar si krijime të mirëfillta. Kanë munguar partiturat, ku pa të s'mund të bëjmë një analizë të thukët, sepse kjo disiplinë dhe kjo veprimtari artistike nuk përmban teza dhe hipoteza, siç janë disiplinat të tjera, por meritojnë të vlerësohen nga fillimet e saj, pra të interpretohen dhe të rivlerësohen vlerat e tyre të mirëfillta artistike, jo vetëm për nga shtrirja e tematikës muzikore, por edhe për nga procedimi dhe mënyra e endëzimit të tekstit sakral, të cilat plesken në makro dhe mikrostrukturat e figurave stilistike me përmbajtje liturgjike.

Pse e themi këtë?

Mesha nr.1 kompozuar më 1966, si Mesha e parë shqipe në Kosovë e ritit katolik

Gjatë kohës së monizmit këndej dhe më atë anë kufirit kjo muzikë, kjo disiplinë a veprimtari ka qenë e ndaluar dhe nuk është lejuar që edhe ato pak vepra të kompozuar nga At Martin Gjoka, Mikel Koliqi, Fan Stilian Noli, Lorenc Antoni,

Prenk Jakova dhe të tjerët në gjysmën e parë të shekullit XX, të cilat kanë qenë të krijuara si produktet e imagjinatës së tyre me tematikë sakrale që të ekzekutohen, analizohen ose së paku të njihemi me to, por kanë qenë të bunkerizuara dhe të ndaluara nga diktatura komuniste dhe sepse po të gjendej ndonjë veperë me tematikë sakrale, menjëherë gjendej para skuadrave të pushkatimit. Prandaj edhe ato pak vepra që janë krijuar, janë "ruajtur" që të mos shohin dritë dhe nuk kemi mundur të shijojmë së paku bukurinë e tërësishme të këtyre krijimeve, por as atë bukurinë relative. Në këto rrethana, veprat, t'i quajmë monumentale për atë kohë, ishin shprehje e një gjuhe me timbër të veçantë muzikor brenda kontekstit fetar që bënin pjesë midis realitetit dhe idealit estetik, duke konceptuar në bazë të përvojave klasike gjatë shkollimit të tyre në qendrat evropiane, At Martin Gjoka, Mikel Koliqi, Lorenc Antoni dhe të tjerët.

Në veprat e hershme hasim në veçori të krijuara varësisht prej vendit dhe shkollës, në të cilën kanë studiuar teologjinë e me të edhe muzikën. Mirëpo, kjo nuk është temë e shqyrtimit të tanishëm, kështu herë do të bëjmë fjalë për veprën Mesha nr.1 kompozuar më 1966 si Mesha e parë shqipe në Kosovë e ritit katolik. Pos kësaj vepre që paraqet në kuadrin e perceptimeve artistike, veprë me vlerë ta pakontestueshme të kompozitorit të shquar Rauf Dhomit, i cili me operat "Goca e Kaçanikut", "Dasma Arbëreshe", si dhe operën "Muzat e Kalasë" në dorëshkrim ose si thotë autori "Titull tavoline, në përfundim", cilësohet si krijues i parë i operës në Kosovë. Ai me këto dy vepra të vëna në skenën e teatrit të Operës së Tiranës "Goca e Kaçanikut", "Dasma Arbëreshe" në skenën e Operës së Prishtinës, por edhe i Meshës së parë shqiptare në Kosovë i ritit katolik 1966. Në këto vepra, shikuar nga ndjenjat dhe ndijimet, autir ndërfit sublimimin estetik dhe perceptimet artistike, bazuar në sintezimin metafizik, me një semantikë gjithëpërfshirëse muzikore, me një veçanti empirike. Dhomi konsiderohet si njëri



ndër kompozitorët më të mirë në tërë universin mbarë kombëtarë të kësaj gjinie, i cili, me një gjuhë të rrjedhshme, të bazuar në perlat dhe frymën e muzikës shqiptare; paraqesin veçori dalluese, me imazhe të qarta tingëllore e që shprehin tërë atë plotësi karakteristike që gjejnë perceptimin në sensibilitetin tingëllor artistik.

Ç'është e vërteta, kur flasim për këtë krijues, duke çmuar lart veprimtarinë e tij, gjithmonë duhet të kemi parasysh sintagmën e shpalosjes së procedimit të shtigjeve dhe pleksjeve rrëfimesh që lidhen me një gjuhë të qartë e të figurshme si univers i latentes dhe konkretes, edhe pse nga ca muzikologë konsiderohet, fal procedimit të ngjizjes të elementeve të begatshme folklorike, si kompozitor i stilit nacional. Ky kompozitor me mjeshtri të rrallë, në suazat e procedut muzikor, krijon vepra me vlera të vërteta artistike që kanë si subjekt të ashtuquajturës të bukurisë në artin muzikor të shprehura me ndjenja dhe emociione krijuese.

Vlera të ndërliqshme estetike muzikore

Kriteret e vlerësimit të artit të Dhomit përbëjnë idetë themelore për ndjenjën e bukurisë që edhe e lidh me shijen e opusit të tij krijues. Prandaj nuk është e rastit pse ky krijues, pos

krijimtarish së bollshme që bazohet gati në të gjitha format dhe të gjinive të ndryshme me prirje të veçantë për muzikën vokale, i rreket formës madhore të operës. Në kompleksin e saj problemor, në formën e operës, pos timbrit muzikor, hasim edhe tekstin si pjesë përbërëse dhe si një formulim ndër parësoret e që kanë karakter pragmatik. Ai është realizues vlerash të vërteta artistike, duke lënë gjurmë të thella në mbarë jetën muzikore shqiptare, duke zënë gjuhë tash vendin e merituar në Antologjinë e krijimtarisë muzikore dhe në Panteonin e saj tek ne. Nëse e marrim për bazë atë sentencë filozofike se "Artri është realizim shpirtëror, është rezultat i punës individuale, por është edhe aktivitet shoqëror", atëherë s'kemi si mos të theksojmë atë thënie filozofike të Proverbrit latin: "Askush nuk mund të gjykojë për një veperë artistike, nëse nuk është artist", sepse në dukje kjo na paraqitet si qëndrim arbitrar dhe është e paimagjinueshme që për një veperë artistike të flasë ai që nuk i njeh sa duhet ligjëroritë e brendshme të artit të të krijuarit.

Pse e them këtë, sepse veprimtaria e tij artistike si disiplinë dhe veprimtari estetike ngjizen mu në veprat e këtij kompozitori me talent, edhe pse vlerësohen dhe rivlerësohen nga aspektet estetike metateorike, shpesh muz-

ikologët tanë kanë dhënë mendime tendencioze si përmbyse paradoksale, pa u thelluar në problemet dhe për fenomenet, të cilat ai i trajton. Siç dihet, "krijimi është vlerë e përjetshme që mban në vete një semiotikë dhe kërkon një studim të themelë jo vetëm nga aspekti i ligjshmërive estetike, por i atyre emocionale dhe imagjinatave pse jo edhe të atyre filozofike", thoshin filozofët antikë dhe e ripërsëritin edhe këta bashkëkohorë.

Pra se t'i bëjmë vlerësimet e veprës së tij me metodat dhe kodet muzikologjike, duke i lënë mënjane disa kufizime, larg moralizimeve vulgare, kam pasë shkruar një artikull dhe botuar në librin tim "Vibracionet e shpirtit shqiptar", me rastin e 60 vjetorit të lindjes së këtij kompozitori, pos tjerash kam theksuar se "është kënaqësi që në një koncert solemn të shohim një auditor kaq të zgjedhur sikurse me atë rast. Kishin ardhur shumë intelektualë të shquar, akademikë dhe anëtarë të qeverisë e deri të kryeministrit. Në të njëjtën kohë është për të ardhur keq mungesa e kolegëve të vokacionit, sidomos e profesorëve të Fakultetit të Arteve, të cilët studentëve të tyre duhet t'u shërbejnë si model". Kjo nuk është për t'u habitur, sepse, mu këta kolegë kanë mendime nihiliste. Me të drejtë filozofi i njohur kinez Konfuciu thotë: "Të studiosh pa

u menduar është e pa dobishme. Të mendosh pa studiuar është e rrezikshme". Sepse "Arti zgjerohet kufijtë e imagjinatës si vepër e dhuntisë dhe elokucionit si rrëfim artistik në vepër gofë letrare, muzikore, artet pamore dhe të tjera dhe sipas Ajnshtajnit, rëndësia e ndërtimit të imagjinatës dhe intelektit është para diturisë".

Janë shumë dallime e veçori të krijimtarisë së Dhomit që në krahasim me kolegët e tij e duke u nisur nga estetika dhe shprehja, spikatin jo vetëm sferën e krijimit dhe të mendimit muzikor, por edhe atë të perceptimit estetik si akt njohës. Lirisht mund të themi se këtu qëndron esenca e krijimtarisë së Dhomit, i cili në veprat e veta nxjerr konkluzione nga shumë aspekte si nga aspekti i bukurisë (Melodia), fisnikërisë (fjala e dhënë), shprehja (ligjërimi muzikor-narracioni), si dhe të shumë elemente të tjera po aq të nevojshme.

Para se të flasim për Meshën nr.1 gjinisë së muzikës sakrale në mënyrë eksplicite që është edhe temë e këtij shkrimi si dhe për të hyrë në thelbin e problemeve gjithëpërfshirëse artistike, do të shfletojmë në pika të shkurtra një curriculum vitae, që paraqet një pasuri të veçantë, duke na prezantuar një krijimtari të madhe gjatë këtyre gjashtëdhjetë e sa vite të jetës dhe të krijimtarisë së tij të madhe, për t'u lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me veprat e krijuara, duke iu referuar kulturës së tyre të madhe, natyrisht se kjo paraqitje skematizim e që nuk mund të paraqesë tërë atë krijimtari në të gjitha aspekte sipas gjinive dhe formave.

Krijimtaria e Rauf Dhomit, e pasur dhe larmishme

Krijimtaria e Rauf Dhomit është e madhe, e pasur dhe larmishme. Ka kompozuar në të gjitha gjinitë e muzikës, me prirje të veçantë, siç thamë edhe më parë për muzikën vokale- koralet e shumta dhe veprat skenike ku përveç operave që i përmendëm, ka shkruar edhe muzikë për teatër dhe film, e cila është me një numër impresionant rreth 300 e sa për skenat e Tetarit të Prishtinës, Gjakovës, Pejës, Shkupit, Prizrenit etj.

Ky bard i muzikës shqiptare, pos krijimtarisë muzikore, paralelisht ka punuar e punon edhe si pedagog i shquar në disa fakultete. Puna e tij është gërshtetur në organizimin e manifestimeve të ndryshme të mbarë jetës muzikore shqiptare.

Ka lindur në Gjakovë më 4 dhjetor të vitit 1945 në një familje jo vetëm me traditë qytetare, por edhe me ato muzikore. Shkollën fillore e ka kryer në vend lindje, kurse atë të mesme muzikore në Prizren. Akademinë muzikore e mbaroi në Sarajevë në degën e kompozimit dhe të dirigjimit në klasën e profesorit të njohur Mirko Shpilër, 1965-69, ku gjatë viteve 1972-1973 kreu edhe



studimet postuniversitare në të njëjtën Akademi muzikore dhe të i njëjti profesor.

Punoj në fillim në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe themeloi Korin e Burrave të Gjakovës, kurse në mars të vitit 2003 R.Dhomi ka themeluar trupën e Operës së Kosovës, Filarmoninë, kurse më 1.01.2004 themeloi Konservatorin Artistik në kuadër të këtij institucioni, po ashtu ka mbajtur një kohë të gjatë edhe postin e drejtorit të parë të Filarmonisë e të operës së Kosovës dhe është profesor ordinar në Fakultetin e Arteve të Prishtinës.

Është anëtarë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Pra, kjo shumësi aktivitetesh që, po të shikohet nga këto këndvështrime, me plot gojë mund të themi se kredoja e tij krijuese bazohet në trinomim krijues pedagog, dirigjent i suksesshëm duke dhënë kontribut të madh dhe të veçantë në tri këto gjini artistike duke krijuar botë magjike me një gjuhë imagjinare dhe kështu ndërton vepra të reja me fuqinë e muzikalitetit të tij të madh.

Në konceptin aksiologjik, në veprat e tij të para na zbulohet talenti i tij siç janë "Uvertura solemne" për orkestrë simfonike, 1969, kënga solo "Dashuria e parë", për zë dhe pianoforte në tekstin e A.Z.Çajupit,

"Passacaglia", "Scherzo", "Kujtime", "Variacione", "Sonata" për piano të gjitha për piano solo, "Te mulliri përmbi vijë", për kor të përzier dhe solist si dhe vepra më kapitale e asaj periudhe krijuese "Mesha nr.1" e para në Kosovë, për kor të përzier. Të gjitha këto pra, paralajmërojnë një krijues të talentuar, i cili krijimtarinë artistike e sheh si formë specifike të përvetësimit të realitetit sipas ligjeve të së bukurisë si dhe krijimit, bazuar në vlerat e reja të kodeve estetike,

pse jo edhe filozofike. Pothuajse në të gjitha veprat e tij të para, që nga "Uvertura solemne" hasim në një melodikë të qartë, të bukur, të ndërtuar në suazat e një ekuilibrimi të rregullt me një arkitekturë hijelehtë që përbëjnë konstruktin e bazuar në formën si shprehje e brendshme shpirtërore të kombinuara shumë lloj- llojshmërisht midis tyre si synime artistike.

Në "Uverturën solemne", pos ritmit, melodikes, harmonisë që paraqesin një realitet metafizik, kemi edhe një moment tejet të rëndësishëm personalizimin e artit si vetëdije krijuese, sepse që nga kjo vepër sikur kompozitori përcaktohet për një stil, kredo të veçantë, stil të dallueshëm nga të gjithë autorët të tjerë shqiptarë, si një qasje artistike pluraliste, si sistem i komunikimit artistik, si ngjizje e një të shprehurit impulsiv që rrjedh nga imagjinata e tij e pasur, si vlerësim relativ me plot metafora dhe figura të shumta të estetikës muzikore, si marrëdhënie reciproke që vjen nga natyra e artit në përgjithësi. Trajtimi i veprës në fjalë, nga aspekti i kodeve muzikologjike, është rrjedhojë e një mendimi të pasur muzikor, të konstruktuar në një formë të qartë muzikore, duke iu qasur me plotë bindje se "Arti i vërtetë është mbi të gjitha art kombëtar, është vetëdije kombëtare", të cilës ky krijues i shquar i ndeji besnik deri në fund kësaj krijimtarie të bollshme. Edhe në veprat pianistike kemi, pos figuracioneve të bukura, edhe një procedim muzikor të qartë, një veçanti si interpretim i një kategorie të veçantë estetike dhe epistemologjike, ku mbizotërojnë prirja e trajtimit të problemeve muzikore të panjohura deri më atëherë. Për këtë të asaj kohe, ishte tepër i ri në moshë për jo kacakof me ato probleme bashkëkohore që ishin prezentë në tërë atë kohezion, duke përfshirë edhe krizat e

mprehta të problemeve teorike e pse jo edhe estetike, filozofike edhe metodologjike.

Me qenë se më vonë me një shkrim ose studim të veçantë të veprave të tij vokalo-instrumentale, do të ndalemi më seriozisht dhe më gjerësisht, po e koncentrojmë vëmendjen tonë në analizën e Meshës së parë nr.1 që konsiderohet si krijim i parë i këtij lloji në muzikën shenjte në Kosovë e ritit katolik. Vështrimi im do të rezultojë jo vetëm si analizë muzikologjike, por edhe për kah praktika metodologjike muzikore, shikuar jo vetëm nga aspektet e formës, ritmit, harmonisë, por edhe nga thelbi i këndvështrimit estetik dhe thellësia e trajtimit të saj; jo vetëm në kompleksitetin, por edhe në universalitetin e veprave të këtij krijuesi të njohur. Në kushtet tejet të pabarabarta në kuadrin e krijimtarisë së gjithmbarshme muzikore, Muzika sacra ose si e quajmë shqip muzikë shenjte, ka qenë e ndaluar jo vetëm që të krijohet, por edhe të ekzekutohet, përfshirë këtu edhe klasikët botërorë si janë veprat e këtij zhanri të krijuesve Monete-verdi, Bahu, Mocart.

Pra, siç thamë, meqë krijimtaria e tij është e madhe dhe e larmishme, po fillojmë që nga veprat që kanë peshë më të madhe e që janë operat "Goca e Kaçanikut" operë në dy akte dhe tri tablo, 1971/72, "Dasma arbëreshe" operë në tri akte, 1982/83, "E bukuria More" balet në tri akte 1984, "Muzat e Kalasë" 2004 (titull tavoline, në përfundim).

Prej veprave të shumta vokalo instrumentale dallojmë Requiem-in, vepër e papërfunduar 1966/67, "Vatra e urtësisë" kantatë për solistë, kor, recitatorë dhe orkestrë simfonike, teksti E.Gjergjeq, ABCD-e Manastirit, Oratori për solist, kor kor fëmijësh, recitator dhe orkestrë simfonike, 2008, pasojnë Rondo për violonçel dhe orkestrë

simfonike, 1965, "Partizani në luftë po shkante" për kor dhe orkestrë simfonike 1966-83, "Uratë vashave" kantatë për solistë, kor dhe orkestrë 1990, me rastin e 100-vjetorit të shkollës së Parë shqipe 1990 dhe të tjera,

Veprat për orkestrë: Uvertura solemne, 1969, Scherzo, 1966, Epopeja 1978,

Uvertura nga opera "Goca e Kaçanikut" dhe Suitë simfonike, 1993, 9 këngë solo, 25 vepra muzikë dhome, mbi 20 përpunime të këngëve popullore, mbi 10 përpunime të këngëve patriotike dhe vepra sakrale Mesha nr.1, për kor të përzier, 1966, Alleluja, për kor të përzier 1989, Mesha nr.2 për kor të përzier, 1968, Uratë për kor të përzier, popullore gjakovare, 1990,

Vajto moj botë me ne, - për kor burrash dhe kor të përzier, 1991, Kyrie eleison, Bethlemi, Ejani popull me hare, Plima-Plima, O Jezu Krisht, Mesia ndër ne, Barinjtë fatlum, Gloria in excelsis Dio, Të krishterë shpetoni, Ave Maria, Nën Tereze, E shenja natë, Fukaraja, O Zot mos më ndaj prej teje të gjitha për kor të përzier, dhe të tjera.

Muzika sakrale ndër shqiptarët nuk ka ndonjë traditë të madhe. Veprat ose këngët e para ndër ne me elemente sakrale kanë filluar të përkthehen nga gjuhët e huaja qysh në mbarim të shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX, kur priftërinjtë e nacionaliteteve të ndryshme shërbenin në kishat katolike në Shqipëri dhe Kosovë. Edhe pse nuk kemi shënime të sakta për këto konstatime, nga Kantuali i Don Nikollë Minit mund të hasim në këngë të përkthyer nga kantualet italiane, gjermane, franceze, kroate dhe të tjera, por kemi edhe ca këngë të mëvonshme që i ka krijuar populli vetë, si materializim i këngës dhe folklorit shqiptar.

Pritja e shekujve – Jezu Krishti

■ SHKRUAN:
Don Lush GJERGJI

E tërë historia e njerëzimit nuk është asgjë tjetër, përpos një lloj gërshetimi në vazhdimësi në mes të së kaluarës, historisë, të tashmes dhe të ardhmes, mes pritjeve dhe zbatimeve, realizimeve, kërkimeve, zbulimeve, të arriturave, mundësive dhe mangësive.

Pritja, që me fjalë tjera mund të quhet edhe shpresa, apo edhe “ëndërrimi” me sy të hapur për një të ardhme sa më të mirë dhe të lumtur, synimi për një botë më të mirë, më të drejtë, më njerëzore, disi “ndryshe” – është tipar, karakteristikë dhe veçori për çdo njeri të çdo kohe apo hapësire.

Për ne të krishterët pritja e shekujve është Jezu Krishti, Shëlbuesi i mbarë njerëzimit, në të cilin “gjendet drita e vërtetë e misterit të njeriut”/krh. GS 22/.

Krishti është Principi dhe Shembulli i njerëzimit të ri dhe Ai lartësohet nga ana e besimtarëve si “I Prituri i njerëzimit dhe Shëlbuesi i botës” / AG 8/.

E Lumja Nëna Tereze, duke medituar për misterin e madh të mishërimit të Zotit në Shpellën e Betlehemit, e më vonë nëpërmjet Kishës dhe Eukraistisë, edhe në jetën tonë, ndër të tjera dëshmonte dhe thoshte kështu:



“Jezusi ka ardhur për t’na zbuluar dhe dhuruar Atin. Në Besëlidhjen e Vjetër Zotin e njohim si Hyjin e frikës, të ndëshkimit dhe të hidbërimit. Ardhja e Jezu Krishtit e ka ndërruar tërësisht këtë botëkuptim. Në Jezu Krishtin Hyji është Dashuri dhe Falje...”

Unë dhe ju duhet të përdorim atë çka na ka dhuruar, për çka Ai na ka krijuar...

Zoti na ka krijuar për gjëra të mëdha: për të dashur dhe për të dhuruar dashuri...për t’ua dhuruar të tjerëve vetë Jezu Krishtin...

Njerëzit nuk kanë uri për ne, për veprat tona, për mirësinë tonë. Njerëzit kanë uri për Zotin, për Jezu Krishtin, për Eukaristinë. Kjo është dashuria në vepër, ose dashuria aktive...

Ne në tokë nuk mund ta shohim Jezusin, dhe mu për këtë nuk mund t’ia shprehim apo dhurojmë dashurinë tonë. Mirëpo për çdo ditë

i shohim dhe jetojmë me të afërmit tanë... dhe do të duhej të kemi për ata atë dashuri dhe atë gatishmëri, çka do të ishim të gatshëm ta bënim për vetë Jezu Krishtin, po të ishte sot i pashëm apo i dukshëm në botë...

Tazbatojmë dashurinë dhe vetëm atëherë pritjet e botës nuk do të jenë më zhgënjim, dështim, pakënaqësi, sepse nëpërmjet dashurisë do ta gjejmë DASHURINË – JEZU KRISHTIN...

Paratë nuk mjaftojnë për ta shuar etjen dhe urinë e njeriut. Të varfrit e mi kanë nevojë për Dashuri, që t’i duam me zemër dhe që t’i shërbejmë me duart tona. Jezusi shërbehet me mua, me ju, si me ndonjë “vegël” për t’na lidhur me të varfër. Kudo që shkoj betoj se njerëzit kanë nevojë për Zotin dhe shi për këtë me anë të dashurisë t’i duam njerëzit dhe nëpërmjet saj t’ua dëshmojmë dhe dhurojmë Hyjin...

Koha e Ardhjes është si koha e pranverës për natyrë, kur çdo gjë përtërihet, lulëzon, gjallëron. Ardhja e Jezu Krishtit do të duhet t’i plotësojë në ne këto pritje, mundësinë e mishërimit dhe të jetësimit të Jezu Krishtit, të dashurisë dhe pranisë së Tij në botën e sotme...”.

Mbi lindjen e Jezu Krishtit në Betlehem dhe në Eukaristi Nëna Tereze dëshmonte:

“Lindja e Jezu Krishtit në shpellën e Betlehemit sollti gëzim në botë dhe në zemrën e çdo njeriut. I njëjti Hyj bëhet Fëmijë – Njeri dhe vjen shpesh në zemrat tona nëpërmjet Kungimit...”

Unë nuk mund të paramendoja asnjë ditë dhe orë pa Jezusin, sepse Ai është jeta ime, dashuria ime, gjithçka për mua. Ai erdhi në botë për t’na dhuruar Lajmin e Gëzuar se Hyji na do, se Zoti është Dashuri, që na do mua dhe ty, dhe që edhe ne lypset të duhemi me të njëjtën dashuri, si na ka dashuri dhe na do Ai ne të gjithëve...

Kur e shikojmë shpellën e Betlehemit, atëherë e kuptojmë sa dhe si na ka dashur duke u ftijuar. Kur e meditojmë Kryqin, kuptojmë si na ka dashur: vdiq në kryq, sepse na deshi paskajshmërisht... Kur e adhurojmë Jezu Krishtin në të

ZOTI E DO SOT BOTËN

Zoti e do sot botën nëpërmjet nesh...
Ai na ka dashur ashtu
Sa që në kryq ka vdekur për ne.
Aq shumë na ka dashur
Saqë për çdo ditë bëhet Buka e Jetës.
Edhe ne lypset të duam,
Edhe ne duhet të dhurohemi deri në dhembje...
Sepse Zoti e do botën nëpërmjet nesh.
Ai vazhdon ta dashurojë botën
Duke na dërguar në botë
Që të jemi Dashuria e Tij,
Drita e Tij,
ngushëllimi i Tij.

Gonxhe Bojaxhiu - Nënë Tereza, Mësimë të dua /Lebte mich zu lieben/, Rozafë, Prishtin, 2003, fq. 48.

DASHURIA

Nëse dëshiroj ta di sa e dua Krishtin,
Nëse dëshiroj ta di a jam vërtet e dashuruar në Zotin,
Duhet shikuar si veproj
Në punën që Ai ma ka besuar
Dhe sa dashuri kam në këtë veprim.
A sheh, thirrja jonë nuk është veprimi,
Misioni ynë është t’i përkasim tërësisht Jezusit,
Me siguri të plotë se asgjë s’do t’na ndajë prej dashurisë së Tij.
S’ka rëndësi se çka punojmë
Apo sa punojmë
Por sa dashurojmë dhe sa dashuri kemi në punën
Që na është besuar.
Atë çka ti vepro
Ndoshta unë s’mun ta punoj...
Atë çka unë veproj
Ndoshta ti s’mund ta punosh...
Por të gjithë së bashku bëjmë
Diçka të bukur për Zotin.

Gonxhe Bojaxhiu - Nënë Tereza, Poezi dhe Uratë, Fondacioni Kulturor i Kosovës “Nëna Tereza”, Prishtin, 2000, fq. 24.



Sbenjtërueshmën Sakrament, në Kungim, atëherë e kuptojmë sa na do sot dhe gjithnjë...

Përvuajtëria është rruga në e sigurt kah shenjtëria, që Zoti të mund të bëjë vepra të mëdha me ne, si bëri me Virgjëren Mari... Të gjithë njerëzit janë të ftuar në këtë bashkim me Krishtin i cili është Drita e botës...”.

Në meditim mbi udhëtimin dhe takimin e Marisë me Elizabetën Nënë Tereza thotë: “Gjëjamë e bukut që bëri Virgjëra Mari, pasi e kishte pranuar Jezusin në krahërorin e saj virgjëror, ishte

udhëtimi i saj në shpejtësi drejt shtëpisë së Elizabetës, për t’ia dhuruar asaj Jezusin, si dhe birit të saj të palindur, Gjonit...

Maria ishte misionare e vërtetë dhe nuk pati frikë për të qenë shërbëtorja e Zotit... Ajo është modeli si si duhet të jetojmë dhe të veprojmë, që ta mishërojmë dhe dhurojmë Jezusin të tjerëve, mbarë njerëzimit...

Shërbim që Virgjëra Mari e bëri për Elizabetën, e bëri edhe për mbarë njerëzimin, duke e bartur, lindur dhe dhuruar Jezu Krishtin të gjithëve...”.

Aspekte pedagogjike të problemit të marrëdhënieve paramartësore

■ SHKRUAN:
Mihály Szentmártoni

Sot shumë flitet për „edukatën e tërësishme“, d.m.th. për edukatën e tërë njeriut, me zhvillimin e tërë aftësive dhe mundësive të tij. Ky ideal do të ishte dashur të shtihet në përdorim edhe në edukatën seksuale. Pedagogu gjerman Klaus Thomas në mënyrë shumë të bindshme dhe të qartë e ka përpunuar këtë princip. Pikënisja e tij është se seksualiteti i përket jo vetëm fushave të veçanta apo specifike të jetës së njeriut, por e përshkon tërë personin e tij dhe shprehet gati në të gjitha fushat e jetës. Kjo në teori, vëren Thomasi, është mirë e njohur, e pra në praktikë të edukatës seksuale ai fakt nuk e ka gjetur zbatimin e vet të përshtatshëm. Ai tërë fushën e seksualitetit e ka ndarë në shtatë dimensionë që barazi janë të rëndësishme me seksualitetin e shëndosh, të baraspeshuar.

1. *Dimensioni anatomik-biologjik*. - Sot më nuk diskutohet

se a duhet t'iu mbarten njerëzve të rinj sa më shumë informata mbi faktet e seksualitetit apo jo, por pyetja shtrohet si të mbarten ato njohuri në mënyrën më të përshtatshme. Është e nevojshme që seksualiteti qysh në atë shkallë të vendoset në *tërësinë e trupit të njeriut*, pra në dallimin prej ndërtimit të tërësishëm të trupit, duke pasur para sysh funksionin jetësor të sekseve.

2. *Dimensioni fiziologjik-funksional*. - Thomas këtu mbështetet në principin e përgjithshëm fiziologjik: një organ jo vetëm se e ka një funksion por ai është ky funksion. Kjo domethënë se një organ mund të kuptohet vetëm duke u nisur nga detyra dhe akti i tij. Patologjia e ka kaluar rrugën zhvillimore nga patologjia organike deri te ajo sistematike, çka do të thotë se nuk ka patologji të izoluar: nëse është i sëmur një organ, është i sëmurë i tërë trupi. Në të njëjtën mënyrë organet seksuale nuk mund të kuptohen të izoluar nga funksionaliteti i vet. Seksualiteti është i kuptimit vetëm në tërësinë e personit njerëzor që është o mashkull o

femër dhe si i tillë i aftësuar për riprodhim të jetës së re.

Dy dimensionet e përmendura, d.m.th. biologjike dhe fiziologjike, përfshijnë një nocion qendror, i cili veçanërisht qartë vjen në shprehje në fushën e seksualitetit: *bios*, jeta. Prandaj është qëndrim i drejtë këtu: seksualiteti? - Po! Mirëpo në kohën e vet dhe në caktimin e vet jetësor.

3. *Dimensioni individual-psikologjik*. - Duke filluar nga puberteti e më tutje në qendër të edukimit seksual qëndron dimensionin seksual. Të rinjtë duhet të ballafaqohen me tendosje, sprovime, shqetësime, disharmoni, aspirata dhe brengosje. Qëllimi i edukatës është që personi i ri të arrijë *respektin* para një personi tjetër, para një „Ti“, para partnerit me të cilin gjatë do të ndajë jetën. Figura kryesore (udhëheqëse) pozitive më atë rast është martesë harmonike si ideal: bashkësia jetësore për të cilën ka llogari të pritë dhe të punohet, të përgatitet për të me anë të detyrave të përditshme.

4. *Dimensioni social-psikologjik*. - Seksualiteti nuk mund të nda-

het as prej rolit të tij shoqëror. Këtu është detyra e edukatës që njeriu i ri ta gjejë „Unin“ e vet në mënyrë që të mund t'i kthehet njerit „Ti“ dhe që në atë mënyrë ta realizojnë dhe së bashku të rriten deri te „Ne“. Fjala është për aftësimin e të edukuarit për kontakte të pjekura ndërmjetëzore: *edukata për partneritet*. Kjo do të thotë sendërtim i qëndrimit në të cilin kërkohet e mira dhe gëzimi i tjetrit, interesohet për punën e tij dhe merr pjesë në brengat e tij.

5. *Dimensioni psikologjik-psikiatrik*. - Në kontekstin tonë kjo do të thotë se edukimi seksual nuk mund të ndahet nga edukimi i karakterit. Ideja kryesore është të njihet motoja: *Njibe vetveten!* Ndërkaq kjo përfshin strukturën dinamike të personalitetit. E thjeshtësuar: fjala është për zgjidhjen e konfliktit elementar ndërmjet instiktive dhe të arsyes në njeriun. Në qoftë se ai problem zgjidhet pozitivisht, seksualiteti mbetet diçka kompulsive, sepse perceptohet si pjesë jo e integruar e personalitetit.

6. *Dimensioni moral-etik*. - Detyra morale është të dallohet (ndahet) e mira prej së keqes në fushën e seksualitetit. Ideja kryesore është: përgjegjësi për veprimin personal, d.m.th. pranimi i pasojave të akteve (veprave) personale dhe mirëqenia e personit tjetër. Qëllimi është edukimi i ndërgjegjes dhe thellimi i të reflektuarit. Shkurt, edukimi për zbulimin e vlerave të jetës. Sot tashmë edhe në psikologji përsëri po hyn një kohë nocióni i refuzuar „i vlerës objektive“, d.m.th. i vlerës që e tejkalon njeriun në kuptimin se ai nuk e ka krijuar, e që duhet nderuar: jetën, rendin moral.

7. *Dimensioni religjioz-krishterë*. - Detyra elementare këtu është edukata për fenë, e cila e pranon se krijimi i njeriut të tërësishëm, duke përfshirë edhe seksualitetin e tij, sipas gjykimit të vet Krijuesit, është „diçka shumë e mirë“. Kjo njohje i jep bazë pranimin elementar të jetës dhe qëndrimin pozitiv ndaj të gjitha gjërave të krijuara. Nga një qëndrim i tillë lind falënderimi për vetveten dhe trupin personal. Vetëm kjo është e aftë ta zgjidhë mërzinë dhe drojë; ajo krijon hapësirë për gëzim dhe çlirim. Edukata e krishterë shton edhe një element që është karakteristik për të: përvoja e faljes. Vetëm aftësia të dish të falësh jep rast që jeta gjithmonë të

mund të fillojë përsëri. Qëllimi elementar i edukimit religjioz në kontekstin tonë është *harmonia e shëndosh* ndërmjet religjiozes dhe erotikes.

Disa shkaqe psikologjike për përmbytjen para martesës

Edhe pse kemi thënë se psikologjia si e tillë nuk futet në kualifikimin moral të një akti të veçantë, megjithatë ekzistojnë edhe disa shkaqe psikologjike që flasin në favor të përmbytjes para martesës. Fjala është për pasojat negative që përvoja paramartësore seksuale mund t'i ketë për cilësinë e martesës së mëvonshme.

Përvoja e parë seksuale e ka një domethënie të jashtëzakonshme, qoftë në kuptimin pozitiv qoftë negativ. Në atë pozitiv: vajza në rend të parë, por sigurisht edhe mashkulli, mbetet afektivisht e lidhur me atë përvojë të parë. Nëse ajo përvojë nuk ka qenë me bashkëshortin e ardhshëm martesor, në jetën e mëvonshme seksuale edhe me pa dashje partneri i vërtetë martesor gjithmonë do të krahasohet me atë përvojën e parë, që me kalimin e kohës mund ta prishë lidhjen afektive. Mirëpo më të shpeshta janë pasojat negative, siç do ta shohim më vonë, e në qoftë se përvoja e parë është negative, ajo mund ta determinojë një ton hedonist të të gjitha marrëdhënieve, d.m.th. qëndrimi elementar ndaj seksualitetit bëhet negativ.

Ndoshta nuk hyn direkt në këtë diskutim, mirëpo mirë është të përmendet edhe kjo: rrëziku ekziston edhe për fëmijën eventualisht të zënë. Në rastin e shtatzënisë jo të dashur janë të mundshme tri zgjidhje: 1. Djali martohet me vajzën për shkak të fëmijës. Shumë martesë lindin në mënyrë që të „korrigjohet“ hapi i gabuar. Praktika vërtetohet se martesë të tilla nuk janë nga më të lumturat. 2. Nëna mbetet vetëm me fëmijën, e punësuar, e pavarur. Fëmija në atë rast më së shpeshti i dorëzohet mirësisë së të tjerëve: të kopshteve të fëmijëve, të kushërinjve apo të fqinjëve, në rastin më të mirë të gjyshes. Nuk ka babë. 3. Disa, ndoshta si zgjidhje më e mira, mbrojnë adoptimin e fëmijës. Kjo „zgjidhje“ s'do koment! Gjithsesi qëndron se fëmija i padashur „paramartësor“ shkakton më shumë brengë se gëzime.

(Përktheu: P. Shtjefën Dodes SJ)

(vazhdon)

“Edukata e krishterë shton edhe një element që është karakteristik për të: përvoja e faljes. Vetëm aftësia të dish të falësh jep rast që jeta gjithmonë të mund të fillojë përsëri.”



Babi, të kemi pritur për çdo Krishtlindje!

Pas lindjes së Krishtit, i krishterë nuk mund të jetë i vetmuar. Në Krishtin e Nazaretit Zoti e ka ndërpre jetën e vet hyjnore dhe iu ka bashkangjitur njeriut, duke u mishëruar, u bërë njeri. Ai këtë e bëri nga dashuria për ne. Këtë mund ta kuptojë vetëm njeriu që ka zemrën e gatshme për t'i dalë në takim Zotit. Nëse i analizojmë pak më mirë tekstet e Besëlidhjes së Re, do të kuptojmë se Krishtlindja është e përshkuar me fjalën *u nisën*. Kështu Engjëlli shkoi te Maria për t'i kumtuar lajmin e gëzueshëm. Maria me nxitim *u nis* tek kushërira e vet Elizabeta. Më vonë me Jozefin, ajo do të *niset* për Betlehem. Drejt Betlehemit do të *nisen* edhe barinjtë dhe e ndjekur zërin e engjëllit. Drejt Jerusalemit do të *nisen* edhe Tre mbretërit, duke e ndjekur yllin e çuditshëm. Maria dhe Jozefi me Jezusin do të *nisen* për Egjipt për t'ia shpëtuar jetën nga Herodi gjakpirës. Pas vdekjes së Herodit ata do të *nisen* për Nazaret.

Asnjë nga këto u *nisën* nuk mund të shpjegojnë në aspektin thejshet njerëzor. Qëllimi i tyre i vërtetë është në zemrën e Zotit që e do njeriun dhe në zemrën e njeriut, e cila me dëgjueshmëri i përgjigjet kësaj dashurie.

Gjoni atë ditë u kthye vonë në banesën e vet, e cila ishte e ftohtë, e parregulluar; gësendet e hedhura nëpër dysbye. U ul në poltronë dhe filloi të mendojë për vetminë e vet, jetën që po e bënë, për të gjitha. Ishte i lodhur, sepse edhe sot si çdoherë më parë me shoqërinë e vet ishte kthyer pas punës në restorant. Me biznesin që merrej, shpesh herë duhej të udhëtonte nëpër vende të ndryshme. Disi filloi ta urrente vetveten, sepse edhe ato pak gëzime që ia sillte jeta me plot aventura, filluan t'i mërzhiten! Asgjë më nuk e bënte të lumtur! Nuk shkonte më as te mikui e vet Pjetri, sepse e vërente që ai kishte familjen e vet të cilës i kushtonte aq shumë kujdes.

Përpara kur për herë të parë kishte ardhur në këtë shtet, diku para ro viteve, dhe kishte gjetur një punë të mirë, gjithëkja i dukej ndryshe. Atëherë ishte i ri dhe merrte të gjitha nga jeta, pa marrë parasysh ishte e mirë apo jo?! Edhe pse edhe atëherë vërehej se ky njeri po iu prej dikujt dhe po fshih dikë? Më vonë, kur mikui i tij Pjetri u martua dhe u bë njeri familjar, Gjoni filloi të mendojë gjithnjë e më shumë për veti dhe jetën e vet. Megjithatë, me punë të përditshme dhe i dhënë pas shoqërisë së keqe, e ngulfate zërin e ndërjegjes.

Vitin e kaluar për Kërsbëndella, si çdo herë tjetër, Pjetri e thirri mikun e vet Gjoni për drekë. Gjoni me ta shkoi edhe në kishë... Dhe në të diçka filloi të thyhet. Vërejtje se si ato ditë të kësaj feste të bareshme dhe jeta familjare e mikut të vet



Pjetrit, i flisnin edhe Gjoni: Jeta jote, Gjoni, është atje ku e ke familjen si mikui yt Pjetri, atje ku e ke lënë Marinë tënde, disa muaj pas martesës. Dhe fëmija që ka ardhur në botë pas shkuarjes sate në kurbet, tash mund t'i ketë ro vjet. A thua ku janë ata?

Ajo që u thye në zemrën e Gjoni për Kërsbëndellat e kaluara, këtë vit u aktualizua edhe më tepër. Shumë mirë i kujtohet Gjoni kur erdhi tek Pjetri dhe u sollti dhurata fëmijëve të tij. Sa u ngasbërye kur i pa fëmijët e tij të gëzuar. Nuk mundi më të duronte dhe filloi disi të rrëfehet: Edhe unë në vendlindjen tonë kam familjen, të cilën e kam braktisur. Dëshiroi të vazhdonte më tutje, por Pjetri e ndërpreu duke u munduar ta qetësonte: Mos, Gjoni, ne e kemi ditur se ty diçka është kah të mundon! Ne nuk kemi mundësi të të ndihmojmë, por ne lutemi për ty çdo ditë. Ti ndoshta nuk e kupton, por lutja mundet me të ndihmues. Lutur edhe ti Gjoni!

Lutja ishte fjalë e huaj për Gjoni. Tani, për deri sa qëndronte i ulur në dhomën e vet të ftohtë, iu kujtuan prindërit e tij, se si me ta si fëmijë shkonte ne mesbë të dielave. Iu kujtuan edhe Kërsbëndellat, sa gëzim dhe bare të shkosh në Mesbë të mesnatës. Iu kujtuan edhe shumë çaste gëzimi në rrethin familjar Iu kujtuan edhe martesë me Marinë, një vajzë e bukur. Iu kujtuan edhe kundërshtimi i tij, sa herë që bashkëshortja Maria i thoshte që të shkojnë në Mesbë të dielave. Duke menduar në këtë mënyrë, Gjoni e vërente se duhet të ndërmarrë diçka, sepse kështu më nuk mundet. Ndoshta do të shkojë edhe në kishë. Nuk mundem më! Jam lodhur nga udhëtimet, miqtë, aventurat, nga jeta. A thua vërtet është kjo jetë? Jo, kur e shoh Pjetrin se sa i lumtur është, jeta ime nuk mund të qubet fare jetë, mendonte në zë Gjoni.

Vërtet Gjoni edhe kishte dashur të jetë si Pjetri, por nuk pati forcë t'i u kundërshtonte ngasbënjimeve

të jetës në Perëndim. Por pse ai e kishte lënë Marinë e vet të dashur? Ah, kurbeti?! Kishte ardhur vetëm për pak kohë për të punuar dhe për të siguruar një ardhmëri më të lumtur për familjen e vet. Mirëpo, me ardhjen e vet në kurbet, asnjëherë nuk i shkroi letër familjes. Disa herë e thirri në telefon Marinë. Herën e fundit ishte kur Maria me gëzim i tha se është shtatzënë. Kjo Gjoni aq shumë e hidhëroi? Ai dëshironte të kënaqej në këtë jetë, dhe i hidhëruar i tha: Mari, ne jemi të rinj, nuk kemi kohë tani për fëmijë. Të lutem **pastrohu** sa ma parë prej tij, për fëmijë e kemi tërë jetën. Pas një pauze të shkurtër u dëgjua zëri i Marisë: Gjoni, ti nuk ke të drejtë me kërkua një gjë të tillë... Ne të presim Gjoni... E dëgjoi edhe një herë duke qarë Marinë dhe u ndërpre lidhja.

Të presim... të presim... i je bonte në vesh zëri i bashkëshortes Marisë. Ishte dëshpëruar: Mua të më presim kaq shumë vite? Iu kujtua kurorëzimi, premtimi i besnikërisë dhe dashurisë deri në vdekje: Po, si mundet Maria të më pret mua që nuk e meritojë një gjë të tillë?! Jo unë nuk kam të drejtë një mirësi të tillë, nuk e meritojë dashurinë e saj! Ah, kthimi për mua nuk ka kuptim...

Ishte i dëshpëruar. U ngrit nga kollukua dhe shkoi për të pirë siç zakonisht vepronte në këto situata! Megjithatë diçka e ndali: Jo, Gjoni, mos pi alkoool! Më mirë pi kafë, edhe kështu u bë mëngjes dhe ti duhet të shkosh në punë! Edhe pak ditë dhe erdhen Kërsbëndellat, festa e gëzimit, e unë këtu jam i vetmuar, i pikëlluar në këtë mjerim të mëkati dhe dëshpërimit. Dubet diçka me veprua! vazhdimisht pëshpëriste Gjoni.

Gjoni të nesërmen, në vend që të shkonte në punë, shkoi në kishë. Hyri ngadalë dhe menjëherë afër vërejtje një pikturë dhe një qiri të ndezur. Ishte vizatuar Krishti me duar të shtrira. Shkoi drejt saj dhe

pa dashje ra në gjunjë. Edhe pse nuk dinte as të lutej, megjithatë sytë i shkuan në fjalët e shkruara pranë duarve të Krishtit **Ejani të unë të gjithë ju që jeni të lodhur dhe unë do t'iu çlodhë!** Pastaj shkruante edhe: **Eja, mikui im dhe më thuaj çka kërkon? Vuan apo ke humbur rrugën? Më thuaj! Unë i mbushi zemrat tuaja me gëzim dhe iu fshijë lotët, unë jam forca e të lodhurve!**

Gjoni i gjunjëzuar, duke shikuar figurën dhe pas leximit të këtyre fjalëve mendoi në veti: Këto duar të Krishtit, të shtrira, a thua do të më ngritin edhe mua, mua që kam humbur rrugën e jetës? Gjoni nuk i kujtohet kur ka qarë kështu në zë. Qante duke u lutur në zë: O Jezu, unë kam humbur, unë i kam shkelur premtimet të dhëna njerëzve që kanë pasur nevojë për mua, unë e kam përbuzur dashurinë e atyre që më së shumti më kanë dashur të gruas dhe të fëmijës. Nuk mundipër të folë deri në fund fjalën fëmijë. Por unë as që kam drejt më me thënë: gruaja ime dhe fëmija im! Unë i kam braktisur ata. Jezu, unë jam i lodhur prej të gjitha! Më fal! Më fal...

Gjoni u tremb, sepse pranë tij u afrua meshtari që kishte dëgjuar lutjen e tij. Mikui im, getësohu, të është falur mëkati! Shko atje, atje ku të presin. Gjoni ngadalë u ngrit në këmbë dhe mezi i tha meshtarit: dëshiroj të rrëfehem. I lumtur doli nga kisha. Por tani atij iu dukej vetja se po shtruron. Prapë i jehoi në veshë zëri i Marisë: **Gjoni ne të presim!** Vraponte drejt banesës, ku më të shpejt i mori pak gardërobë dhe duke shikuar banesën iu dukej aq e mbarsht sa edhe vet mëkati e tij. E lajmëroi edhe mikun e vet Pjetrin; Po kthehem te familja ime, kurrë nuk kam qenë më i lumtur. Të lutem më arsyeto në punë. Makinën dhe banesën i ke në dispozicion! Më në fund unë jam i lirë, Pjetri!

Pritjen e aeroplanit mudohej ta kalonte duke pirë cigare pas

cigares. Posa hyri në aeroplan, nuk dinte çka të mendonte më përpara, por pasi që ishte i lodhur e zuri gjumi! U zgjua në zërin e stjuardesës që të lidhen, sepse për disa minuta do të aterojnë. Nga aeroporti e mori taksin për në shtëpi. Por kur iu afrua asaj filloi të frikësohej dhe të mendojë: Çka nëse Maria nuk ka nevojë më për mua, nuk dëshiron të më takojë? Apo ndoshta nuk është më aty? Dhe derisa iu afrohej shtëpisë së vet pas dhjetë viteve i kujtoheshin të gjitha: kurorëzimi me Marinë, premtimet e bëra në kishë, fjalët e saj që është shtatzënë. Por ndoshta më presin ende, e ngushëllonte veten. Dhe ashtu ngadalë iu afrua shtëpisë, e cila ishte e zbukuruar me dritat e Kërsbëndellave afër bredhit në derë të hyrjes e vërejtje një letër të shkruar bukur: Babi, ne të presim edhe për këto Kërsbëndella! Gjoni u mbajt për derë që mos të rrëzohet! Si ta kalon pragun e shtëpisë, ta bën hapin më të rëndë të jetës së vet. I ra ziles, kur e dëgjoi zërin e Marisë: Është e hapur! Disi mbloodhi forcë që të hyjë, por mezi arriti në dhomën e pritjes ku ishte Maria dhe djali që kur e panë u shtangën nga habia! Gjoni ra në gjunjë para Marisë: Mari, në emër të Jezusit që ma ka falë gabimin, të lutem më falë edhe ti! Maria ngadalë u ul pranë tij dhe lotët që i rridhnin dëshmonin se ajo e falë bashkëshortin e vet. Gjoni ne vazhdimisht jemi lumtur për këtë ditë! Gjithmonë kemi besuar se një ditë do të kthehesh! Dhe ja ti erdhe bash natën e Kërsbëndellave! Gjithmonë kemi shpresuar! Faleminderit, o Zot!

Djaloshi, i cili ishte i hutuar me krejt këtë ngjarje, e afrua ngadalë dhe me gjysmë zëri tha: Babi, ne të kemi pritur për çdo Krishtlindje!

Don Albert Demaj

Simbolet e Krishtlindjes

Kurora e Adventit

Përdorimi i kurorës së Adventit duhet ndërlidhur me një traditë të vjetër gjermane, para asaj të krishterë. Traditë kjo që ka ardhur prej një riti pagan të dritës, që kremtohej në muajin e Yules (dhjetorit). Në XVI shekull hyri në traditën e krishterë në kohën e përgatitjes për festën e Krishtlindjes.



Tre mbretërit (dijetarët)

Në ungjillin sipas Mateut flitet për tre dijetar që prej lindjes ja bënë për në Jerusalem, pikërisht në Kohën kur mbretëronte

Herodi, në kërkim të një sapolinduri. Ata qenë dërguar dhe drejtuar në Betlehem, ku edhe gjetën Jezusin fëmijë dhe

Kurora e Adventit është një rreth me fleta lisi me ngjyrë të gjelbër (simbol i shpresës dhe i jetës), me katër qirinj, që simbolizojnë katër javët e adventit. Sipas një tradite çdo qiri e ka një domethënë: qiri i profetëve, i Betlehemit, i barinjve dhe i engjëjve.

familjen e tij. Këtu dijetarët e adhuruan foshnjën dhe i dhuruan ari, kem dhe mirë.

Të lajmëruar në ëndërr për njetin e Herodit ata u kthyen në një rrugë tjetër. Kush janë saktësisht këta njerëz, prej nga vinin dhe ku shkuan apo përfunduan pas lindjes së Jezusit? Janë pyetje që shumë kronistëve u interesojnë. Emrat e tyre janë: Melchiorre, Gasparre, e Baldassarre. Melchiorre njihet si më i vjetri, dhe që ai që ia dërgoi arin Jezusit. Gasparre ishte ai që e dërgoi kemin që është shenjë nderimi ndaj hyjnisë së Jezu Krishtit. Dhe Baldassarre ishte ai që paraqiste pjesën e njerëzve me ngjyrë të zezë, përfaqësues i popullatës afrikane.

Historia e "Baba Dimrit"

Baba Dimër, në gjuhën italiane quhet Babo Natale, që do të thotë Baba i festës së Krishtlindjes, ndërsa në gjuhën gjermane Santa Claus. Historia e Babës Dimër fillon me Shën Nikollën nga Mirra, njëri ndër ipeshkvijtë e parë të Azisë së vogël, kulti i të cilit u përhapë sidomos në mesjetë, ku nëpër shumë legjenda janë protagonist fëmijët. Për këtë arsye, ky shenjt edhe sot e kësaj dite mbetet pajtor i fëmijëve dhe ata vit pas viti presin dhurata nga ai.



Kambanat

Kambanat u bënë pjesë përbërëse e festës së Krishtlindjes qysh prej vitit 400. Tingëllimi i tyre fronte popullin për të marrë pjesë në meshë dhe kjo ishte edhe lidhja e parë që vazhdon edhe sot e kësaj dite. Është edhe traditë, bie fjala në Angli, kur afrimi i festave lajmërohet me kambana; në Skandinavi përfundimi i përgatitjeve lajmërohet me kambana; gjithashtu me kambana lajmërohet edhe ardhja e atij që jep dhurata...etj.



Betlehemi

Betlehemi është reprezentimi apo paraqitja e Lindjes së Jezu Krishtit në një grazhd, me figura të ndryshme të familjes së shenjt, të tre mbretërvë, të barinjve, dhe të disa shtazëve. Që Shën Frani i Asizit që e bëri popullor përdorimin e Betlehemit, kur

natën e Krishtlindjes se vitit 1223, ftoj një familje të vejnë fëmijën e tyre të sa po lindur në një stallë, pranë disa shtazëve sikur lopët dhe gomarët. Qëllimi i Shën Franit ishte të potencoj anën njerëzore të Jezu Krishtit.



Bredhi i Krishtlindjeve

Të shumta kanë që përpjekjet për të gjetur një gjenealogji antike për bredhin e krishtlindjeve, dhe me të shumta janë edhe teoritë të cilat arin deri tek popujt me të vjetër siç janë babilonasit, egjiptianet etj. Por e vetmja teori e fortë ka mbetur nga se kjo bimë ka praninë e elementit vegjetal edhe në festat dimërore. Një histori mesjetare pak a shumë e dokumentuar e gjejmë në të ashtu quajturën Historia e Lisit të Parajsës. Ndër misteret më

të mëdha që tregoheshin në Mesjetë, pa dyshim ishte ajo e krijimit dhe e përjashtimit të Adamit dhe Evës nga Parajsa. Skena e këtij përjashtimi ishte një lis, shpesh herë i mbushur me

pemë (molla). Përkëtë arsye edhe njerëzit pastaj vazhduan të mbajnë këtë kujtim, edhe në liturgji data e 24 dhjetorit kujton Adamin dhe Evën. Vetëm në vitin 1660 e kemi dëshminë e parë të disa regjioneve protestante që e dekorojnë bredhin me qirinj.



Një legjendë përkritazi me festat e Krishtlindjes

Një herë në një fshat të humbur të fushës, pikërisht Natën e Krishtlindjes, një djalosh shkoj në pyll në kërkim të drunjtëve për t'i djegur në oxhak, sikur kërkonte tradita. U vonua më shumë se parashihej dhe në të kthyer, pasi që u terrua e humbi rrugën. Për fat të keq të tij filluan edhe disa fjolla bore të bien në tokë. Djaloshi filloi të brengosej dhe ankthi e përfshiu duke menduar se sa e kishte pritur festën e Krishtlindjes e tani i humbin shpresat për ta festuar. Në pyllin tani me të zhveshur nga fletët pa një lis (bredh) akoma të gjelbër dhe hyri në të dhe u mbrojti nga bora. Filloi të ndihet i lodhur dhe shumë shpejt e koti edhe gjumi. Lisi (Bredhi) i shtyrë nga fuqia e borës i lakoi rremat e tij deri

në tokë, duke e mbrojtur kështu djaloshin nga të ftohtit dhe nga bora. Të nesërmen u zgjua nga zhurma e bashkë-vendasve që ishin në kërkim të tij. Si doli nga ai vend strehim pati mundësinë e përqafimit më familjen dhe farefisin.

Vetëm atëherë të tjerët panë spektaklin që gjendej para syve të tyre: bora e rënë gjatë natës, në rrema të bredhit kishte formuar disa dekorime interesante në formë të kristalit që në dritën e agimit dukeshin dritëza të mrekullueshme dhe të pakrahueshme. Dhe në kujtim të kësaj legjende edhe sot e kësaj dite bredhat e Krishtlindjes kanë ruajtur anën varëse drejt tokës dhe janë bërë simbol i festave të Krishtlindjes.

(Përgatiti don Jeton Thaqi)



Ti që e do Nënë Terezën dhe ndërtimin e Katedrales, uroje, ndihmoje, realizoje, duke thirrur në numrin

0900-901-101

Çdo thirrje e jote të kushton një euro.

**TA NDIHMOJMË
NDËRTIMIN E KATEDRALES**

*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bami­rës të dashur, ju mundësojmë ta jepni kontributin përmes xhirolloqarive bankare.

Faleminderit!



 **Raiffeisen BANK**
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:

EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë *"Drita"*. Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë "Dritën"** (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë:
Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.

Emri: _____

Mbiemri: _____

Adresa: _____

Qyteti: _____

Kodi postar: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.



DRITARIA

"Dritra hulumt
kanëfë errësirës
kur ndihet..."
KEPËLLER

E PËRMUAJSHME FETARE • KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Nëntor 2009 • Viti XXV • Nr. 11 (46) • Çmimi: Rreth 14, Europë 10, Zëritë për, SHBA 14.50



**Venerat krysoshe
në fundkallorë të
mosës**



**Karimë e Zëri
Prizrenpallatë të Aulës**



Eshkolini për dëshori



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur



Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

Mërkur

<